



SHIKOJ.COM

# GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU

(1405-1468)

Prej

PESHKOP FAN STILIAN NOLIT

*Doktor i Shkencave Filozofike*

SHTËPIA BOTONJSE «NAIM FRASHERI»

**Titulli i Origjinalit:**  
**GEORGE CASTRIOTI SCANDERBEG**  
**(1405-1468)**  
by  
Bishop Fan Stylian Noli, Ph. D.  
International Universities Press  
New York 1947

Tirazhi: 7000 kopje

Formati: 78 x 109/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tirane, 1967

## **Tomas Taunsend-it (Thomas Townshend — më vonë Lord Sidnej)**

*Njohuri tē mëdha tē artit ushtarak mund tē nxirren nga jeta e Gustav Adolfit dhe nga ajo e Karlit XII, mbretit tē Suedisë, si edhe nga jeta e Ziskës së Bohemisë; dhe do tē ishte një punë e paçmueshme, po tē mund tē sigurohej një përshkrim i mjaftueshëm i bëmave tē Skënderbeut, sepse ai shkëlqen midis gjithë gjeneralëve tē kohëve tē vjetra dhe tē sotme si udhëheqës i një úshtrie tē vogël mbrojtëse. Skënderbenë e kam gjetur në Historinë e Turqisë, por askund gjetkë...*

**Gjenerali Xhejmz Uollf (James Wolfe)**

*Devizes, e dielë, 18 korrik 1756  
(Willson, fq. 296-297)*

## FAN S. NOLI, HISTORIAN I SKËNDERBEUT

Përpara 400 vjetësh, poeti i shquar freng Ronsard, në një vjershë, mburrte një vepër të mikut të tij Lavarden mbi Skënderbeun, duke thënë se, në qoftë që fama e heroit shqiptar do të jetonte për shekuj, kjo do t'i detyrohej këtij historiani të ditur. Nuk do të thotë të bësh një mburrje të tillë të tepruar që i bën dhunë së vërtetës, po të thuash se, në qoftë që shqiptarët e sotëm e njohën historinë e Heroit të tyre të pavdekshëm, kjo i detyrohet për një pjesë të mirë punës e pendës mjeshtërore të poetit e patriotit, historianit e mendimtarit tonë të shquar, Fan S. Nolit.

Vepra e tij «Histori e Skënderbeut<sup>1)</sup>» botuar në Boston më 1921, arriti të bëhej një libër popullor, që e përcolli shqiptarin që nga bangat e shkollës fillore deri në moshën më të pjekur dhe e bëri ta dashurojë e ta adhurojë këtë figurë të madhe të historisë së popullit tonë.

Duke u marrë me figurën e Skënderbeut qysh nga vitet e para të veprimtarisë së tij publicistike, të pakën qysh nga viti 1907, e deri në një moshë madhore, si poet, historian e komponist, Fan Noli kreun jë detyrë të madhe që i pat vënë vetes Rilindja jonë: t'i jepte popullit shqiptar një tablo sa më të gjallë, të vërtetë e frysmezuese të jetës, veprimtarisë e

1) Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastriotit), Mbretit të Shqipërisë, 1412-1468, botuar prej shoqërisë korçare «Arësimi», Boston, 1921.

kohës të kësaj figure të madhe të historisë sonë kombëtare, që është njëkohësisht një figurë e madhe e historisë evropiane.

«Historia e Skënderbeut» e vitit 1921 i kishte të gjitha cilësitë për t'u bërë një libër popullor: me stil tërheqës e gjuhë të mrekullueshme ajo tregonte, duke ndjekur biografinë e shkodranit Marin Barleti, ngjarjet plot peripeci dramatike të jetës e veprimtarisë së Heroit; madje mund të thuhet se një nga arësyet e suksesit të saj ishte se ajo kishte ruajtur aq shumë nga karakteri panegjirik i modelit të saj, biografisë së Barletit.

Libri i vitit 1921 ishte shkruar më tepër me dorën e letrarit patriot, se sa të një historiani kritik; ai mbështetej kryesisht mbi burime të dorës së dytë, siç ishin biografitë e Heroit të shkruara në kohë të vona, kurse burimet e dorës së parë, materialet arkivale bashkëkohëse, Noli atëherë ose nuk i njihte, ose **nuk** i kishte në dorë. Këto burime arkivale do ta kishin ndihmuar t'i jepte tregimit të jetës e veprimtarisë së Heroit tonë një bazë më të saktë faktike dhe t'u shmangej një vargu gabimesh e të metash.

Një e metë kryesore e veprës ishte se në radhë të parë asaj i mungonte kuadri shoqëror-ekonomik i Shqipërisë në shek. XV — një e metë karakteristike për pothuajse të gjitha veprat kushtuar historisë së Skënderbeut dhe për historiografinë borgjeze në përgjithësi. Si pasojë, ngjarjet e jetës e veprimtarisë së heroit tonë shikoheshin të shkëputura nga kushtet e jetës së masave popullore; këto kushte nuk konsideroheshin aspak si faktorë për të spjeguar ecuninë e **luftës**, për të spjeguar fitoret ose disfatat e saj. Si pasojë, me gjithë dëshirën për ta afruar me masat popullore, figura e Heroit që jepte Noli mbetej një **figurë e idealizuar**; arësyet e fitoreve të korrura nga Skënderbeu, ishin cilësitë e tij ideale, që e bënin të shembellente më tepër me një figurë legjende se sa me një figurë reale, historike.

Është meritë e madhe e F. Nolit fakti që ai nuk u kënaq me atë që kishte arritur por, përkundrazi, me

një qëndrim të rreptë kritik ndaj vetes, mundi të bëhej i ndërgjegjshëm për të metat e veprës së vitit 1921 dhe të gjente forcat për t'ju kthyer edhe një herë, pas 25 vjetësh, kësaj teme, duke u përpjekur për një kuptim më të thellë e më të argumentuar të kësaj epoke. Fryt i këtyre përpjekjeve dhe një paraqitje më e qartë dhe programatike e pikëpamjeve të tij të reja është libri i dytë i F.S. Nolit kushtuar Skënderbeut, botuar anglisht më 1947 në Nju Jork me titullin «George Castrioti Scanderbeg», libër që po i paraqitet sot i përkthyer shqip lexuesit shqiptar.<sup>1)</sup>

Duhet thënë që në fillim se libri që kemi përpara shënon në shumë pikëpamje një hap të rëndësishëm përpara dhe meriton vemendje si një etapë e re më e lartë jo vetëm në krahasim me librin e parë të Nolit, por me gjendjen e studimeve skënderbegiane në përgjithësi.

Kjo vepër e paraqitur si disertacion për të fituar doktoratën e shkencave historike, dëshmon se autori i është përveshur punës duke u preqatitur dhe armatosur me gjithë mjetet e kritikës historike, me një njojje të plotë të burimevet, dhe veçanërisht të burimevet arkivale, që i kishte munguar punës së tij më 1921.

Autori i veprës që kemi përpara ka shfrytëzuar burime të reja ose të lëna pas dore nga studjuesit e mëparshëm, të cilat lejojnë të sqarohen disa çështje me rëndësi. Kështu, për shembull, në një koleksion dokumentash mesjetare të Bosnjës, Noli gjen një indikacion që lejon të zgjidhet problemi i prejardhjes së familjes së Kastriotëve nga një fshat Kastriot ose Kastrat në Has, Malësi e Gjakovës. Nga një vepër e humanistit Enea Silvio Piccolomini (më vonë Papa Piu II),

---

1) Më 1950 Noli botoi shqip, po në SHBA, një libër me titull «Historia e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Kryezot i Arbërisë», që është një përpunim i Historisë së vitit 1921 në dritën e pikëpamjeve të tij të reja. Libri është ribotuar dy herë në Shqipëri (1962 e 1967).

Noli na bën të ditur se s'qe vetëm Gjergj Kastrioti që përqafoi islamin, porse këtë e kish bërë më përzantine të shekullit të Skënderbeut është Noli i pari që shfrytëzon jetëshkrimin e Mehmetit II prej Kristobulit nga Imbras; këndej ai nxjerr jo vetëm të dhëna me vlerë mbi luftrat e viteve të fundit të Skënderbeut, por na jep në mënyrë të veçantë të dhëna për pjesëmarrjen e masave popullore në këto ngjarje vigate, pikërisht atë që mungon në informatat e thata të burimevet arkivale. Koloriti i kohës është edhe më i gjallë, të dhënat për pjesëmarrjen e masave janë edhe më me interes te disa kronistë turq, që i ka shfrytëzuar gjithashtu për herë të parë për historinë e Skënderbeut Fan Noli. Pikërisht pse vijnë nga goja e kundërshtarit, këto të dhëna kanë një vlerë të veçantë dhe zgjerojnë njohuritë tona mbi gjendjen e Shqipërisë në këtë kohë.

Një e metë që mbetet akoma në punimin e ritë Nolit është fakti se ai vazhdon të përdorë si burim të dorës së parë disa burime tregimtare shumë të dyshimta. E kemi fjalën për historinë e të ashtuquajturit «Tivaras», për të cilën historianë me autoritet kanë shprehur mendimin e argumentuar se kemi të bëjmë me një falsifikim të një falsifikatori profesionist të shek. XVIII, Xhamaria Biemi.<sup>1)</sup> Për shkak të këtij burimi kaq të dyshimtë, Noli lë qëllimisht pas dore një burim si biografinë e hartuar nga shqiptari Marin Barleti, të cilin kërkimet e reja po e vërtetojnë gjithnjë e më tepër si një burim në kuptim të plotë autentik e të dorës së parë.

Megjithëse vepra e 1947-ës në krahasim me «Historinë» e 1921-së paraqit shumë përmirësimë dhe përparime, munt të themi se shtytja kryesore për t'u marrë me historinë e Heroit, për Nolin nuk ka qenë synimi për të saktësuar gabimet, për ta plotësuar nga ana faktike. Noli na thotë (faqe 199) se ai ngurroi.

---

1) F. Babinger, Die Gründung von Elbassan, Berlin 1931, fq. 94.  
K. Ohly, në Gutenberg-Jahrbuch 1933, Mainz, f. 53-61.

për një kohë të gjatë gjersa ju përvesh punës së re. Ajo që e shtyti ishte gjëndja e pakënaqshme e historiografisë, nevoja të shtrohej e shqyrtohej si problem qendror roli, funksioni, karakteri i figurës së Skënderbeut dhe i luftrave të tij në sfondin shoqëror - historik të Shqipërisë dhe të Evropës. Nga skjarimi i këtij problemi qëndror do të rridhnin pastaj vetvetiunjë varg konkluzionesh dhe hollësirash për të përcaktuar edhe më mirë figurën historike të Heroit tonë.<sup>1)</sup>

Çdo epokë e shtron rishtas problemin e rëndësisë dhe të funksionit historik të një heroi, dhe çdo epokë i përgjigjet ndryshe këtij problemi. Historia e famës së Heroit tonë gjatë shekujve dëshmon se kjo famë është rritur sa kohë që lufta kundër pushtimit osman ishte një problem jetësor për popujt e Evropës Jugë-Lindore; për aq kohë edhe figura e Skënderbeut në historinë evropjane kishte një funksion të caktuar, që të mobilizonte forcat e popujve në luftën për jetë a për vdekje me pushtonjësit e huaj, për aq kohë edhe figura e Heroit tonë në letërsinë historiografike, popullore dhe artistike shërbente si një flamur i gjallë për të mobilizuar masat në luftë për çlirim. Vetëm pas realizimit të çlirimit dhe bashkimit kombëtar të popujve t'Evropës, pasi e kaloi borgjezia fazën e saj luftarake, fillon të duket te disa historianë një qëndrim skeptik, përcmonjës kundrejt Heroit tonë; këta rrëzojnë në pluhur atë që e kishin ngritur në qiell të tjerët: kështu më parë anglezi E. Gibbon, më vonë gjermani G. Voigt dhe rumuni N. Jorga, dhe në ditët tona disa historianë të rij turq. Pas luftës së madhe antifashiste, ku pjesëmarrja e masave popullore lojti një rol kaq të rëndësishëm në shpartallimin e okupatorëve, figura e Skënderbeut u bë prapë aktuale dhe fitoi një vlerë të re. Vendin e drejtë dhe të merituar

---

1) Me këtë rast duhet shtuar se Fan Noli jep një gjykim tepërtë favorshëm e të pajustifikuar nga vetë faktet mbi veprën e historianit shqiptar A. Gegaj botuar frengjisht me titull «L'Albanie et l'invasion turque au XVe siècle» në Paris më 1937. Mjafton një krahasim me veprën që kemi parasysh, për të konstatuar të metat faktike e metodologjike të punimit të A. Gegajt.

do të mund t'ja japë Heroit tonë, si gjithë figurave të mëdha historike, vetëm historiografia marksiste, duke u nisur nga vlerësimi i drejtë i rolit të masave popullore.

Eshtë meritë e historianit Fan Noli, që ai për herë të parë në historinë e studimeve skënderbegiane, është përpjekur t'u hapë rrugën pikëpamjeve të reja në këtë drejtim. Megjithëse me një metodologji akoma të pamjaftueshme, Fan Noli ka meritën që i pari e ka părë drejt rolin e popullit në luftat e udhëhequra nga Skënderbeu. Luftat i bëjnë popujt dhe atyre u përket merita e vërtetë për fitoret, thotë ai (f. 41), por kjo s'do të thotë se udhëheqësit nuk janë tjetër veçse figura, dhe, si rrjedhim, duhet të shkruajmë historinë pa zënë në gojë asnje emër udhëheqësi. Udhëheqës të mëdhenj janë ata që dinë të përfaqësojnë aspiratat e popullit. Nën një udhëheqës të tillë, populli, siç qe rasti i popullit shqiptar nën Skënderbeun, bën çudira në një luftë popullore.

Këto arësyetime dëshmojnë për përpjekjet serioze të Nolit për të dalë nga rrathi i ngushtë i kuptimit borgjez të historisë dhe nga ana tjetër për ndikimin që ushtroi mbi te historiografia marksiste. Jo më kot një nga fundërrinat e emigracionit zogist, Tajar Zavalani, e akuzoi Fan Nolin se po fuste «marksizmin» në historinë e Skënderbeut! Me këto konsideracione ne hyjmë në thelbin e çështjes, siç e ka shtruar autori në «Hyrjen» dhe në kapitujt «Sfondi» dhe «Fillimet legjendare», që janë pjesa më e rëndësishme e librit të tij.

Në tri pika munt t'i përbledhim ne me fjalët tona mendimet dhe argumentimet e Nolit:

1. — Veprimtaria e Skënderbeut nuk është «një balon i fryrë», siç është thënë, po një fakt historik. Këtu s'kemi të bëjmë rëtëm me operacione banditësh të maleve, po me një luftë gjiganteske me përpjestime evropiane, që zgjati më tepër se një çerek shekulli dhe vuri përballë forcave vigane turke populin tonë të vogël. Mjafton të vërtetojmë, thotë No-

li, se Skënderbeu ka mbrojtur me sukses Krujën kundër tri rrithimeve të Muratit II dhe Mehmetit II, dy pushtonjësve më të tmerrshëm të kohës, që kishin në dorë ushtritë më të forta të botës, mjafton të mendojmë se inkursionet turke bëheshin rregullisht vit për vit dhe dy herë në vit, dhe s'ishin ndërmarrje të improvizuara, por koncetronin epërsinë numerike, eficencën teknike të gjithë ushtrisë së tyre në një pikë të vogël — para Krujës — duke lënë zhveshur gjithë zonat e tjera të perandorisë; mjafton të vërtetojmë këtë — dhe ne jemi plotësisht në gjendje ta bëjmë këtë me material autentik, në bazë edhe të kronikave turke — dhe do të na shtrohet me të drejtë pyetja:

2. — Si spjegohen këto lufta dhe fitore, të cilat në një vështrim të parë duken të pabesueshme? Cilët janë faktorët që kanë kontribuar këtu: konditat e vështira të terenit, vetijat e popullit, gjenia e një njeriu, ndihma e jashtme, apo ka këtu shkaqe më të thella për spjegimin e këtyre fitoreve?

Noli i ka kërkuar këto shkaqe jo në faktorë të dorës së dytë, siç janë p.sh. kushtet e favorshme gjeografike, ndihma e botës së jashtme etj, por në pjesëmarrjen e masave populllore.

Në Shqipërinë e kohës së Skënderbeut, thotë Noli, kishte tri «klasa sociale»: fshatarët e malësive dhe të krahinave kodrinore, tregëtarët në qytetet e lulëzuara të bregdetit dhe «aristokratët e vegjël», ose, siç e thekson Noli, «më mirë, krerët patriarkalë të malësorëve» (f. 44). Strukturën shoqërore të Shqipërisë në këtë kohë e shquajnë raporte karakteristike për fazën parafeudale. Fshatarët rronin në komune të lira, pa njonur akoma ndarjen në klasa dhe shfrytëzimin e klasës. Kjo vlen, thotë Noli, për shumicën dërmonjëse të popullsisë së Shqipërisë (f. 44). Vetëm në rrethet imediate të qyteteve shqiptare që kishte zënë Venediku, fshatarët ishin kthyer në bujqrobër (f. 150). Këto dy klasa, fshatarët dhe qytetarët, të cilët Noli shpesh herë i quan borgjezë (shih p.sh. f. 150) ishin armiq të vendosur dhe të betuar të turqve.

Fshatarët shqiptarë, duke luftuar kundër push-tonjësve turq, mbronin tokën dhe lirinë e tyre. Këtu e kishte rrënjen lufta e gjatë dhe heroike e shqiptarëve kundër turqve nën Skënderbeun, këtu e kanë spjegimin fitoret e tyre legjendare. Ajo është, thotë Noli (f. 47), një «luftë klase» e fshatarëve të lirë shqiptarë kundër feudalizmit turk. Lufta e kësaj fshatarësie të lirë ka qenë kurdoherë shtylla e rezistencës nacionale kundër asimilimit turk gjatë shekujve, (faqe, 151). Me udhëheqës të ri, fshatarët shqiptarë në ditët tona korrën fitore të shkëlqyera si ato të Skënderbeut. Nuk ka dyshim se autori e ka fjalën këtu për fitoret e shkëlqyera që korri populli ynë gjatë Luftës nacionallirimtare.

Sa për aristokratët, disa nga ata lëkundeshin dhe nganjëherë u hodhën nga ana e turkut, por shumica e tyre u bë bashkë me dy klasat e tjera (f. 44). Autori nuk e cilëson më qartë se e çfarë lloji ishte kjo aristokraci, e gjakut (e fisit), apo e tokës (feudale); po ai thekson se ata ishin më tepër krerë patriarkalë malësorësh (f. 44); tokat ku sundonin ata nuk ishin principata, por kantone malore, fshatra të varfëra. Të gjitha këto kanë si qëllim, siç e thotë vetë autori, ta sjellin Skënderbeun më afër popullit të tij, ta shohin atë si një udhëheqës fshatarësh; dhe fshatar ai mbeti, sipas Nolit, edhe si u bë gjenerali më i madh i kohës së tij.

Një meritë e madhe e Nolit është se ai, në lidhje me karakterin populor të luftës së Skënderbeut, ka theksuar edhe karakterin populor të taktikës saj, të armëve të saja: taktikë e luftës guerilje, e luftës partizane, armë tradicionale e fshatarësisë — përtë cilën vendi ynë ofronte kondita të favorshme si në kohën e Skënderbeut ashtu edhe në Luftën nacionallirimtare; ushtria fshatare e Skënderbeut përbëhej kryesisht nga formacione të lehta e të shpejta kalorësish, të pangarkuar nga armaturat e rënda feudale; taktika e tyre ishte shqetësimi i kundërshtarit, prerja e rrugëve të furnizimit, që e mbanin armikun në alarm të vazhduar, dhe më në fund sulmi i pa-

pritur, i rrufeshëm, kur e kish futur armikun në **kllapë** dhe e shpartallonte. Dhe pikërisht si çdo ushtri e përbërë nga fshatarë, ushtria shqiptare ishte e pafuqishme kundër fortësave. Me këtë armë primitive, që Skënderbeu e zotëronte mjeshtërisht, ai qe në gjendje të shkatërronte komandantët ushtarake më të mëdhenj, që udhëhiqnin armatat më të mëdha të kohës.

3. — Po atëhere ngrihet një pyetje e re dhe me rëndësi (f. 37): ku mund ta mësonte Skënderbeu këtë taktikë popullore? Në malet e vendlindjes së tij, apo në pallatin e Sulltanit, siç thonë biografët e tij? Këtë problem me rëndësi, kritika e legjendës që ka mveshur rininë e Heroit gjer tani, thotë Noli, e ka kapërcyer pa e vënë re: disa historianë e kanë pranuar legjendën, disa të tjerë kanë shprehur disa dyshime, sepse legjenda është në kundërshtim me të dhënat e kronologjisë, por asnjeri nuk shkoi aq thellë sa të gjejë një rrugëdalje. Ose legjenda duhet flakur e tëra, ose ndryshuar rrënjosht, përndrysht, përsërisht, tërë biografia e Skënderbeut do të jetë e ndërtuar mbi rërë.

Për këto arësyen kapitulli i titulluar «Fillimet legjendare», është pjesa më me rëndësi e librit; këtu autor i parashtron një version të ri të periudhës së parë të jetës së Skënderbeut, duke i përmbysur krejt pikëpamjet që ekzistonin gjer tani. Për rininë e heroit tonë, dmth për periudhën e përbledhur nga vitet 1405-1443, ne nuk kemi veçse pak dokumenta dhe tradicionin që e shënon biografi i tij i parë Barleti, prej të cilës e marrin dhe e përsërisin biografë të tjerë, midis tyre edhe vetë Fan Noli në librin e tij të vitit 1921.

Mënyra se si e tregon Barleti rininë e Skënderbeut, Nolit i duket si një film aventurash «alla amerikana»; të dhënat e biografit shkodran duhet të jenë marrë, sipas tij, nga këngë popullore shqiptare (f. 68).

Nuk ka dyshim se versioni që na jep Barleti e që e njohim të gjithë, paraqet një varg kontradiktash kronologjike që i shërbijnë Nolit për ta deklaruar të **papranueshëm**. Të tillë janë p.sh. mospërputhja e datës së lindjes së Skënderbeut (1405) me moshën 9 vjeç, kur ai ju dorëzua peng Sulltan Muratit II, i cili në të

vërtetë hipi në fron më 1421, përmendja e emrit të Gjergjit si dhurues dy fshatrash, bashkë me të jatin e vlezrit në një dokument të vitit 1426, në një kohë kur ai duhej të ishte në oborrin e sulltanit, etj.

Pranë kontradiktave të jashtme legjenda paraqit edhe kontradikta të brendshme, thotë Noli. Që një djalë i vogël të rritet në një shkollë pazarësh dhe oborrtarësh myslimanë në pallatin e sulltanëve dhe të mbarojë pastaj si një «kapadai» dhe një nga «kryqtarët kristianë më fanaticë» të kohës, të gjitha këto qenkan aq fantastike sa që na detyrojnë ta shtrojmë edhe një herë legjendën për shqyrtim.

Duke u nisur nga këto kontradikta, që pa dyshim ekzistojnë, dhe duke u përpjekur të gjejë material që mund të mbështeste arsyetimet e tij, autori na jep një version të ri të rinisë së Heroit, një version që e ndryshon, për të mos thënë e rrëzon krejt, mënyrën e gjertanishme që e paraqiste këtë fazë të jetës së Heroit tonë.

Duke përdorur argumentime që lexuesi mund t'i gjejë vetë në tekst, Noli përpigjet të tregojë se s'është më e nevojshme të pranojmë se Skënderbeu u dorëzua si peng që në fëmijërinë më të njomë, se u rrit në shkollën e pazarëve të oborrit, as që u bë musliman nën presion në pallatin e Sulltanit, as që arriti të bëhet favoriti i këtij. Skënderbeu rronte në Shqipëri, ai dërgohej vetëm rastësisht në ushtrinë e Sulltanit për të shërbyer me kontigjentet shqiptare dhe qëndronte gjithmonë nën komandën e t'et d.m.th. nuk shërbente në ushtrinë e rregullt të jeniçerëve (f. 75). Në Shqipëri ai ndërroi fenë sipas shembullës së të jatit. Gjatë luftrave në të cilat merrte pjesë si vasal i Sulltanit, shqiptari i ri, Gjergji, me zotësinë e tij fitoi një titull të lartë ushtarësh dhe mori emrin e ri, që u bë emri i tij i luftës: Skënderbej.<sup>1)</sup>

1) Për hir të së vërtetës duhet thënë se kjo tezë e Nolit në bërrthamë është formuluar qysh në gjysmën e dytë të shekullit XIX nga historiani rus. V. V. Makushev, në librin «Istoričeskije rozyskanija o Sllavjanah v Albanii v srednie vieka» Varshavë 1871, f. 84-85. Bie në sy që Noli, i cili e citon librin, nuk e ve në dukje këtë fakt.

Skënderbeu nuk pat, pra, nevojë të ikte fshehurazi, kundër vullnetit të Sulltanit, nga oborri i tij; tokat e familjes së tij ai nuk i mori në dorëzim kundër vullnetit të Sulltanit, por me lejen e këtij, pikërisht si vasal feudal i Sulltanit. Për t'i këputur marrëdhënjet e vasalitetit me Sulltanin, rasti i mirë ardhı më 1443, me disfatën e turqve në Nish. Në luftë e sipër, përpara murevet të Sfetigradit më 1448, dëajo në pallatin perandorak të Adrianopojës, u njoh dhe u takua për herë të parë Murati II me armikun e tij të tmerrshëm, Skënderbenë (f. 97).

Nuk ka dyshim se versioni i Nolit duket se thjeshton një varg kontradiktash. Në favor të tij flasin, më tepër tërthorazi se sa drejt për drejt edhe disa burime.

Megjithatë duhet thënë se argumentimet e Nolit jadin rast për një varg vërejtjesh kritike. Unë mendoj se kritika mund të përmblidhet rrëth këtyre pikave kryesore: 1) problemi i klasës së cilës i përket Skënderbeu 2) versioni i ri që na jep Noli për rininë e Heroit, 3) vlerësimi i faktorit të jashtëm e në radhë të parë të Papatit. Le t'i shqyrtojmë këto pika më afër dhe njérën pas tjetrës.

1. — Problemi se cilës klasë i përket Heroi ynë e ka preokupuar autorin shumë; ky është një problem tek i cili Noli kthehet disa herë duke na siguruar se te Skënderbeu dhe shokët e tij kemi të bëjmë me krerë që s'janë feudalë, po më mirë krerë patriarkalë (faqe. 44.). Në faqen 153 ai arrin në këtë përfundim: «Klasa së cilës i përket Skënderbeu është një klasë që është më afër fshatarëve se çdo klasë tjetër». Ajo nuk ka baza ekonomike dhe prandaj nuk formon një klasë më vete. Si rrjedhim, «ajo lëkundet në mes fshatarësisë, borgjezisë, aristokracisë dhe proletariatit». Duke lënë mënjanë anakronizmin e qartë që Fan Noli flet për borgjezi e proletariat në një kohë kur këto nuk mund të ishin formuar akoma, duhet theksuar se autor i nuk e ka parë drejt strukturën ekonomiko-shoqërore të Shqipërisë në shekullin XV. Si pas Nolit, në Shqipëri (me përjashtim të qyteteve) nuk ekzistonte akoma diferencimi i shoqërisë dhe ndar-

ja e saj në klasa, në dy klasa themelore karakteristike për kohën feudale — pronarë toke dhe fshatarë të varur e të shfrytëzuar. Te Noli vihet re një tendencë për ta mbuluar ekzistencën e klasave, ndarjen që përshkonte mes për mes shoqërinë mesjetare shqiptare. Autori thotë se robërimi fshatarëve shqiptarë u ka ardhur nga jashtë, nga zotérinj feudalë të huaj (f. 35); se armiqtë e kësaj klase kanë qenë zotérinjtë feudalë turq dhe princët tregëtarë vendikas, që donin ta shfrytëzonin dhe robëronin (f. 153). Ky argumentim dëshmon pikëpamjet idealiste të Nolit, që mohojnë ekzistencën e klasave dhe luftën e klasave si një fenomen të ligjshëm në çdo shoqëri në këtë shkallë të zhvillimit.

Por kjo paraqitje e origjinës shoqërore dhe e karakteristikave të klasës së Skënderbeut bie në kundërshtim me faktet historike që na paraqesin një strukturë ekonomike-shoqërore të ndryshme e shumë më të zhvilluar nga ajo që na jep Noli. Këtu kemi të bëjmë me një të metë themelore të veprës. Aristokracia shqiptare e shek. XV, në të cilën bën pjesë edhe Skënderbeu, kishte një bazë ekonomike të sajën, e cila ishte pikërisht shfrytëzimi i tokës dhe i punës së bujqve që e punonin atë, qoftë si fshatarë personalisht të lirë, qoftë si fshatarë të lidhur pas tokës; dmth kjo aristokraci formonte një klasë më vete me tipare të përcaktuara mirë, klasën feudale. Domenat e tyre dallojnë krejt nga tokat e trashëguara të fshatarëve të lirë. Fakti se origjina e Kastriotëve lidhet me fshatin Kastriot ose Kastrat në Has, kurse domenat e tyre ishin lokalizuar në Dibër dhe në Mat, dëshmon qartë se këtu nuk kemi të bëjmë me fshatarë vendas pak a shumë të pasur, por me tokë, me të cilat Kastriotët janë investuar në mënyrë feudale për shërbime ushtarake. Po përveç këtyre argumentimeve të tërthorta, ne kemi mundësinë ta korrigojmë paraqitjen e strukturës ekonomike-shoqërore të Nolit me anë të materialit dokumentar që na dëshmon haptazi të kundërtën, d.m.th. për zhvillimin e marrëdhënieve feudale në Shqipëri. E kemi fjalën për

materiale që i njeh pa dyshim edhe Noli, por të cilave ai s'u ka dhënë rëndësi. Njëri dokument është i vitit 1426 dhe është një akt dhurimi i dy fshatrave që bën Gjon Kastrioti me katër djemtë e tij në favor të manastirit Hilandar (dokumenti citohet në lidhje me probleme të tjera nga Noli në f. 66, dhe 209, por pa u analizuar përbajtja e tij). Këto dy fshatra janë Radostusha dhe Trebishti në Rekë, afër qytetit të Dibrës. Me këtë akt Gjon Kastrioti heq dorë nga gjithë detyrimet që kishin këto fshatra kundrejt atij, detyrime të cilat i kalojnë tani manastirit. Me këtë rast ne kemi mundësi të shohim se sa kishte përpnuar shfrytëzimi feudal në këtë zonë kaq larg bregdetit dhe qyteteve, se cilat ishin detyrimet e fshatarit kundrejt të zotit të tokës, jo vetëm në natyrë dhe të holla, por edhe në angari personale<sup>1)</sup>.

Këtu nuk bëhet fjalë për gjendjen juridike personale të fshatarëve; një indikacion me interes në këtë drejtim e gjejmë gjetiu. Në një dokument të datës 25 maj 1433, të cilin botuesi N. Jorga<sup>2)</sup> mjerisht nuk e ka dhënë në tekstin origjinal, por e ka përmbledhur me fjalët e tija, senati venedikas u përgjigjet kërkesavet të Gjon Kastriotit, i cili kish kërkuar lehtësira doganore dhe «kthimin e të ikurve». Senati i përgjigjet sundimtarit shqiptar në mënyrë pohonjëse se e «pranon kthimin e skllevërve, të bujqërvë rob dhe të pasurivet (të tyre)».

Nga ky dokument rezulton qartë se në domenat e Gjon Kastriotit sundonin raporte feudale tipike për gjithë mesjetën. Ne gjejmë këtu bujqërit-rob (servi), që ikin nga zgjedha e rëndë e shfrytëzimit feudal në qytete të cilat janë jashtë juridiksionit të zotërisë së tyre feudale — një fenomen i njohur në shoqërinë feudale të gjithë Evropës; gjejmë gjurmat e skllavërisë shtëpiake dhe agrare, që e njohim edhe nga vendet e tjera

1) Shih përkthimin shqip në: Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vell. II, Tiranë 1962, dok. 153, f. 233-234.

2) N. Jorga, Notes et extraits pour servir à l'histoire des croisades au 15<sup>e</sup> siècle, vol. I, Paris 1899, f. 558.

ballkanike në këtë kohë, (shih p.sh. institucionin e otrokëve në kodin e Stefan Dushanit.)<sup>1)</sup>

Që feudalizmi s'është një fënomen i ri, i kohës së Skënderbeut, po që i ka rrënjet thellë në të kaluarën, e shohim nga një përshkrim gjeografik i vendit tonë dhe i vendeve t'Evropës Lindore, që daton nga viti 1308<sup>2)</sup>. Autori anonim na dëshmon këtu ekzistencën e atyre fshatarëve të lirë, barinj të maleve, që rrojnë në ato kondita që na përshkruan edhe Noli, që «nuk kanë qytete, kështjella, qyteza, vende të fortifikuara dhe fshatra, por banojnë në kasolle dhe lëvizin prej një vendi në vend tjetër (të bashkuar) në turma dhe fise». Kurse raporte feudale janë zhvilluar në një së-rë krahanash të tjera, të cilat «u paguajnë tribut atyre shqiptarëve (të maleve) dhe janë pothuajse rob (servi), të tyre» etj.

Ekzistencën e bujkrobërisë e gjejmë ndër të tjera të vërtetuar edhe në një dokument ku perandori bizantin Andronik II Paleologu (1282-1328) u siguron qytetarëve të Kruijës «zotërimet e tyre të lartpërmendura dhe bujqit e (lidhur pas) këtyre tokave» (*predicas possessiones et possessionum colonos aut agricolas*).<sup>3)</sup>

Të gjitha këto të dhëna na paraqesin një pamje shumë më komplekse e më të zhvilluar të strukturës ekonomike-shoqërore të Shqipërisë në kohën e Skënderbeut nga ç'është paraqitja tepër e thjeshtuar dhe idiliqe e Nolit. Fan Noli, duke u nisur nga disa të dhëna të njëanshme të disa autorëve bizantinë dhe turq ka përgjithësuar strukturën e një zone të pjesës së Shqipërisë, siç është zona e malësive të larta, ku baza e ekonomisë nuk ishte bujqësia, por blegtoria, ka përgjithësuar gjendjen e fiseve të barinjve për gjithë Shqipërinë. Këtë gabim e bëjnë një varg autorësh modernë, që përpilen të nxjerrin prej këndejej konklu-

---

1) Shih: K. Jirecek, *Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien*, T. I, Wien 1912, f. 73.

2) Shih: *Anonymi descriptio Europae Orientalis*, ed. O. Gorka, Krakov, 1916, f. 25-29.

3) Shih: Thalloczy-Jirecek, *Zwei Urkunden aus Nord-Albanien*, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, vol. I. f. 149.

zione pa vend për një prapambetje të theksuar të shqiptarëve kundrejt popujve të tjerë fqinjë ballkanas. Të dhëna të shumta për ekzistencën e një bujqësie shumë të zhvilluar në Shqipëri, për ekzistencën e qyteteve të rëndësishme si qendra zejtarie, shkëmbimi tregëtar e kulture, na japid të drejtën të themi se deri në pushtimin osman vendi ynë kishte ecur me ritme të barabarta krahës vendeve të tjera të pellgut ballkaniko-adriatik në zhvillimin e marrëdhënieve feudale.

Nuk ka asnë dyshim, pra, se shoqëria e barinjve që rronin në komunitete fisnore, ishte prej kohësh në dekompozim e sipër, kurse raportet feudale ishin rapportet themelore që përcaktonin karakterin e shoqërisë shqiptare në shek. XV. Por fakti që struktura themelore e shoqërisë është feudale dhe, si rrjedhëm, Skënderbeu rezulton si një pjesëtar i kësaj klase feudale, nuk është aspak në kundërshtim me karakterin popullor të luftës dhe të udhëheqësit të saj, Skënderbeut. Noli mendon se një Skënderbej pjesëtar i klasës feudale, nuk mund të ngrinte edhe të udhëhiqte masat popullore në Shqipëri, që ishin kryesisht fshatare. Duhet thënë se kjo nuk është e drejtë. Madhështia e figurës së Skënderbeut qëndronte pikërisht në faktin se Skënderbeu, megjithëse pjesëtar i klasës feudale, ishte më i qartë, më i ndërgjegjshëm se kushdo tjetër në kohën e tij për rrezikun që po i afrohej vendit me invazionin turk, duke kërcënuar edhe klasën feudale edhe fshatarësinë bashkë; kundrejt këtij rreziku ai, si feudal, kishte mundësinë të mbante atë qëndrim që mbajtën feodalë të tjerë, të lëkundëj, të kërkonte strehë te venedikasit, të hidhej nga ana e turqve; por ai bëri të kundërtën, bëri një luftë të vendosur kundër pushtcnjësve, duke u mbështetur pikërisht mbi masat popullore kundër pushtuesve të huaj dhe njëkohësisht edhe kundër anarkisë feudaie që rrezikonte luftën, duke shprehur këshfu në mënyrë më të qartë edhe më të ndërgjegjshme se kushdo tjetër aspiratat e thella të masave, duke realizuar këshfu nevojat imperative të epokës. Vëtëm një Skënderbej pjesëtar i klasës sundonjëse kishte

mundësinë të mobilizonte në luftë gjithë forcat e Shqipërisë së atëhershme, të organizonte gjithë fuqitë e shpërndara të klasës feudale dhe të fshatarësisë, t'u imponohej në bazë të autoritetit të tij forcave centrifugale dhe të lëkundëshme të feudalëve, të bënte një politikë të jashtme të përshtatur për të fituar aleatë në këtë luftë për jetë a për vdekje. Pikërisht në realizimin e këtyre detyrave qëndronë rëndësia dhe madhështia e kësaj figure. Ai kontribuoi më tepër se kushdo tjetër në këtë fazë për kapërcimin e situatave tashmë të vjetruara e për t'i çarë rrugën asaj të reje që kërkonte si nevojë të domosdoshme epoka.

Si pasojë e injorimit të marrëdhënieve feudale Noli nuk sheh se, si rezultat i një procesi të thellë ekonomik-shoqëror, klasa sunduese kishte krijuar aparatin e vet të sundimit, shtetet feudale, dhe ishte forcuar politikisht. Për këtë arësyё gjithë kjo fazë gjer në ardhjen e turqve karakterizohet nga copëzimi i pushtetit në duart e një vargu zotërinjsh feudale, në mes të të cilëvet zhvillohet një luftë e tmerrshme, që i jep herë njërit e herë tjetrit supremacinë dhe që u lejoi pikërisht turqvet të mundin relativisht lehtë një pas një princat shqiptarë të dobësuar nga kjo luftë. Noli e konsideron këtë në mënyrë tepër të thjeshtë si një periudhë në të cilën «Balshajt, Topiajt, Muzakët, Shpatajt, Buat dhe Kastriotët arritën të bashkojnë fshatarësinë shqiptare në luftë kundër pushtonjësve të huaj» (f. 45).

Rrjedhimisht, nuk del qartë vendi që zënë në historinë tonë veprimtaria e Skënderbeut dhe përpjekjet e tij për kapërximin e anarkisë feudale, ecja drejt formimit të një monarkie feudale të përqëndruar, konditë paraprake e domosdoshme për formacione politike më të përparuara, për formimin e një shteti nacional, siç e dimë nga historia e përgjithshme. Noli thotë (f. 113) se «ishte e natyrshme për Skënderbenë t'i heqë qafës këta krerë centrifugalë dhe t'i aneksojë kantonet e tyre, të bashkojë vendin kundër turqve dhe venecianëve, kurse krerëve s'u mbeste tjetër veçse të kërkonin mbrojtje pikërisht te këta turq ose venecianë».

**Por.** Nolit i shpëton fakti se masat, me anë të të cilave Skënderbeu i bën ballë rivalitetit të këtyre krerëve, janë masa dhune, siç i gjëjmë kudo në Evropë në këtë fazë që shënon kapërximin e anarkisë feudale. Te Noli këto fakte janë shënuar si fakte të veçuara, pa u inkuadruar në vendin që u përket. Domena e Kastriotëve në Shqipëri zinte një pozitë qendrore; përmes saj kalonin vija komunikacioni me rëndësi tregëtarë që lidhnin Veriun me Jugun, Lindjen me Perëndimin dhe sillnin të ardhura të pasura nga doganat. Kësaj pozite të domenës i përgjigjej dhe pozita me rëndësi që zinte familja Kastrioti në mes të feudalëvet të tjerrë. Me anë të një sistemi martesash, Kastriotët ishin lidhur me familjet feudale kryesore dhe nëpërmes të këtyre lidhjeve Skënderbeu përpinqej të neutralizonte armiqësinë dhe rivalitetin e tyre. Kundrejt lëkundjes së feudalëve të mëdhenj, Skënderbeu u mbështet mbi feudalët e vegjël të cilët i lidhi pas vetes me shpërndarjen e feudeve të vogla; në radhët e tyre ai gjeti shokë lufte besnikë, oficerë të ushtrisë së tij. Në përforcimin e pozitës së tij pat ndihmuar pa dyshim edhe mbështetja që ai gjëzonte nga ana e klerit dhe e kishës së krishtere, të cilët me anë të luftës së Skënderbeut donin të mbronin pozitat e tyre të rrezikuara në Ballkan.

Një faktor tjetër që ka kontribuar për ta përfokuar pozitën e Skënderbeut kanë qenë trupat e qëndrueshme me rrrogë, të cilat, në Shqipëri si kudo, e bënë kryezotin të pavarur, gjer në njifarë grade, nga feudalët e tjerë dhe i jepnin atij një mbizotërim ushtarë. Atje ku ky proces u zhvillua pa pengesa, pushteti qendror në formim e sipër gjeti një mbështetje kryesore në një forcë të re që po lindte në gjirin e shoqërisë feudale, dhe që do të sillte një ndryshim rrënjosor në marrëdhënjet shoqërore: e kemi fjalën për tregëtarët e qyteteve që kudo qenë ndihma dhe mbështetja kryesore e pushtetit qendror kundër feudalëve rivalë. Në Shqipëri kjo forcë nuk mundi t'i epte tërësish ndihmën e saj luftës kundër turqve dhe anarkisë feudale. Ky fakt karakteristik për konditat e veçanta të historisë sonë nuk del në shesh të

Noli e gjithashtu nuk dalin në dritë pasojat negative që pat ai për zhvillimin e luftës së Skënderbeut: pikërisht qytetet e pasura tregëtarë të bregdetit, që duhej të jepnin burimet financiare kryesore për luftën, ishin në dorën e Venedikut; ndihma e tyre financiare i mungoi Skënderbeut dhe e detyroi atë të kërkojë ndihmë atje ku të mundte, veçanërisht në vitet e fundit, kur gjithë burimet ekonomike kishin shterrur. Në vend të ndihmës së kësaj shtrese në ngritje e sipër, ekonomikisht më të fortë të shoqërisë mesjetare, Skënderbeu pat ndihmën e një klase tjetër: kjo që fshatarësia, sidomos fshatarësia e lirë malore; mbi shpatullat e kësaj klase ekonomikisht të dobët rëndoi barra kryesore e luftës kundër turqvet, për të mbrojtur tokën dhe lirinë e vet; vërtet ajo i dha Skënderbeut mbështetjen e saj dhe mbizotërimin kundrejt rivalëvet feudalë, po pikërisht në dobësinë e saj ekonomike qëndronte edhe një nga arësyet kryesore që lufta nuk e arriti qëllimin final, një arësyet që nuk ka dalë te Noli. Po nga ana tjetër është e vërtetë, dhe këtë e ka parë drejt Noli, se fakti që një pjesë e fshatarësisë nuk e njihte shfrytëzimin feudal në formën më të zhvilluar të regjimit të bujkrobërisë, se kishte ruajtur lirinë e vet personale, fakti se fshatarsia përbënte pjesën më të madhe të ushtrisë së Skënderbeut, të gjitha këto i jepnin vrullin, forcën dhe karakterin popullor luftës dhe udhëheqësit të saj, një karakter që e kapërxente terenin e kufizuar të një lufte tipike feudale.

Në f. 153 Noli shënon katër aspektet e luftës së udhëhequr nga Skënderbeu: ajo është luftë klase e fshatarëve të lirë shqiptarë kundër feudalizmit turk më një anë, kundër tregëtarëve venedikas nga ana tjetër; luftë për liri kundër dy pushtonjësve më të mëdhenj të kohës dhe më në fund një kryqëzatë kristiane kundër turqve dhe një kapitull shumë i rëndësishëm i historisë së gadishullit ballkanik. Me të drejtë Noli ve në dukje më në fund (f. 156) kontributin e luftës së popullit shqiptar nën Skënderbenë për të mbrojtur Evropën nga katastrofa më e madhe që mund ta gjente atë n'atë kohë. Duke marrë parasysh sa u tha më si-

për për karakterin e klasës në të cilën bënин pjesë Skënderbeu dhe udhëheqësit e tjerë feudalë, duhet thënë se këtu nuk mund të bëhet fjalë për luftë klase të fshatarësisë, por duhet folur përgjithërisht për një luftë çlirimtare, në të cilën marrin pjesë në shkallë të ndryshme klasat e ndryshme të shoqërisë shqiptare; po nga ana tjetër duhej shtuar këtu një aspekt që mund të quhet kryesor: luftat e popullit shqiptar nën Skënderbenë shënojnë një fazë me rëndësi, në të cilën, i nxitur nga nevojat e mbrojtjes, po pregeteje kapërximi nga anarkia feudale në formimin e një pushteti feudal të përqëndruar, konditë paraprake për formimin e një shteti nacional; një fazë ku po pregeteje, i farkëtuar në luftë, uniteti politik i popullit tonë dhe u konsolidua kombësia shqiptare në bazë të gjuhës, territorit dhe unitetit të tij psihik-kultural.

2. — Versioni i ri që na jep Noli për historinë e rinisë së Heroit, me gjithë interesin e madh që paraqit, nuk mund të mos zgjojë një varg objekzionesh kritike. Objekzioni kryesor është se ai është në kundërshtim me të dhënat e dokumentacionit ekzistues.

Noli në disa raste nuk ka marrë parasysh të dhënat e një vargu dokumentash ose të disa autorëve, ose ka nxjerrë nga ato konkluzione që nuk të bindin. Në fillim të 1410-ës Gjon Kastrioti u deklaronte venedikasve se ai gjendej nën presionin e turqve dhe u kish dorëzuar atyre një djalë të vet si peng. Ky fakt duhet të na shtyjë të mendojmë se ai si shumë sundues të tjerë ballkanikë në të njëjtën situatë, ish bërë që atëhere gjer në një farë grade tributar i Sulltanit dhe kish dorëzuar një peng të parë dhe na paralajmëron se ky rast mund të përsëritez. Megjithatë Fan Noli këtë fakt e deklaron thjeshtësisht si «një manevër» që përdor Gjoni për të gënjer venedikasit, për t'u fshehur faktin se ai po fillonte një «flirt», një miqësi me turqit (f. 65). Po ashtu, pa arësyen shtrëngonjëse, Noli e merr tepër lehtë punën me dokumentin e vitit 1428, me anë të të cilit Gjoni largonte çdo përgjegjësi kundrejt Venedikut në qoftë se i biri që «është bërë turk dhe musliman», me urdhër të Sulltanit do të plackiste

tokat e venedikasve. Noli thotë se Gjoni po u shiste prapë venedikasve ato «përrallat e vjetra» si më 1410 (f. 65).

Një konkluzion tjetër të tillë, që s'është bindës, nxjerr Noli nga dokumenti i dhuratës që bëhet në emrin e Gjon Kastriotit e të katër djemve të tij në favor të manastirit të Hilandarit në malin Atos më 1426, duke thënë se deri në këtë kohë të katër vellezërit kishin ndenjur në shtëpi pa shkuar kurrë si peng në oborrin e Sulltanit. Nga ky akt nuk rezulton tjetër veçse fakti që në këtë kohë ata ishin në vendin e vet. Por kjo nuk pengon aspak që njëri ose disa nga ata të kishin qenë larg, të ishin kthyer e të shkonin prapë, ashtu siç ndodhte shpesh në të tilla raste.

Përgjithërisht vihet re se Noli i kapërcen pa i vlerësuar indikacionet e një vargu burimesh perëndimore, bashkëkohase me Heroin, tek të cilat pra nuk ekziston rreziku që ato të kenë qenë ndikuar, siç thotë Noli nga këngët popullore shqiptare, që deshën një farë kohe sa të përhapeshin, ose nga biografia e M. Barletit, që u shtyp shumë më vonë (midis viteve 1508-1510). Kështu dy letra (të viteve 1463-1464) të humanistit F. Filelfo e vërtetojnë shprehimisht atë që mohon Noli, d.m.th. se Skënderbeu u qe dorëzuar turqve si peng që në moshë të vogël, siç e shohim nga vetë shtojca e dokumentave që jep Noli. Të njëjtën gjë thonë edhe dy shkrimtarë të tjerë, të cituar në shtojcë, pa u dhënë rëndësi: J. J. Pontanus dhe R. Volaterranus. Qëndrim të pajustifikuar mban Noli edhe kundër dy autorëve të tjerë bashkëkohës që i ka njobur: Bizantini Laonik Halkokondili thotë për Skënderbenë se «erdhi si djalë i vogël në pallatin e Sulltanit dhe u arratis pastaj në atdhe»<sup>1</sup>); e po atë e vërteton edhe turku Ashik Pasha Zade, duke thënë se «ka qenë pazh i Sulltanit dhe pastaj u shkëput nga Sulltani.»<sup>2</sup>)

Në mbështetje të këtyre autorëve të njobur, por

1) E. Darko, *Laonice Chalcocondyli historiarum demonstraciones*, Budapest 1923 II, 119-121.

2) Shih citatet të I. Radoniq, *Gj. Kastriot Skanderbeg i Arbanija u 15 veku*, Beograd 1942.

të përbuzur nga Noli, flasin edhe disa burime të reja që ai nuk i ka njohur. Këto janë burime me prejardhje lindore dhe janë shkrojtur prej bashkëkohësish të Skënderbeut, të cilët nuk kishin mundësi të njihnin Barletin dhe biografët e tjerë të mëvonshëm, as traditën gojore që u formua në Shqipëri dhe në Perëndim. E kemi fjalën për disa kronistë turq ose europianë që patën rrojtur në Turqi.

Kronika e Dursun Begut,<sup>1)</sup> përmban disa të dhëna me rëndësi për ne; Dursun Begu që ka marrë pjesë vetë në luftrat në Ballkan e në Shqipëri, duke përdorur, si gjithë kronistët turq të kohës, shprehje fyese që në të vërtetë janë mburrje e shqiptarëve, shkruan ndër të tjera për Skënderbenë<sup>2)</sup>:

«Frota shqiptare është e lindur për të kundërshtuar, për të mos u përulur dhe për të bërë inat. Ata... u përulën vetëm nga frika e shpatës së përgjaktë të sulltanit. Po kur shkëlqimi i shpatës u çduk për disa kohë nga sytë e tyre, tradhëtarë Skënder, i cili qysh në fëmininë e hershme ishte edukuar në pallatin e sulltanit, vendosi që të kthehet në kundërshtim..., me veshjen e tradhëtarit në shpinë, ai iku nga pragu i sulltanit dhe u fut në mes të tyre. Ai u tha: Unë jam djali i sundonjësit tuaj...»

Gjithashtu i shek. XV, është kronisti Ibn Kemal, i cili na paraqet një variant me disa të dhëna të reja në lidhje me Skënderbeun<sup>3)</sup>. «Në vendin e shqiptarëve, thotë ai, doli në skenë një njeri prej fisi të vjetër mbretëror, një sojkeq, sherrxhi, ngatërrestar dhe turbullues... Emri i tij ishte Iskender. Ai vetë qëndroi për një kohë të gjatë në shërbim të Sulltan Murat Hanim dhe ishte një nga sherbyesit e brendshëm të atij

1) Botuar në revistën «Tarih-i Osmani enxhumen mexhmusi 3» Nr. 26-38, Stamboll 1914-16.

2) Faqe 135 e botimit turk, te Radoniqi, vepër e cituar, f. 249, Kol. II.

3) Shih vëllimin «Lufta shqiptaro-turke e shek. XV - burimet osmane», pregetitur nga S. Pulaha (botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut) Këtu mund të gjinden edhe gjithë citatet e tjera të autorëve turq që përmendëm më sipër.

perandori... Mbasi u rrit nën shkëlgimin e dritës dhe edukatës së pallatit, ngjeshi shpatën e islamit... ky keqberës u largua nga vendi i muslimanëve... dhe shkoi e hyri me lehtësi në vilajetin e t'atit... populli i vendit të atyre anëve ju nënshtua; ate e tideruan duke thënë se ky është djali i sunduesit tonë...»

Me këto të dhëna të qarta përputhen edhe ato të dy autorëve, të cilët, ndonëse me prejardhje evropiane, mund të rrjeshtohen midis autorëve lindorë, sepse trojtën për një kohë të gjatë në Turqi dhe prej këndej i kishin informata e tyre. Njëri nga këta ishte një serb, i quajtur Konstantin Mihajloviçi nga Ostrovica, i cili si jenicer kishte marrë pjesë në luftrat në Azi dhe në Evropë. Me në fund ai ja doli të ikë dhe kaloi në Hungari e Poloni, ku midis viteve 1496-1501 shkroi kujtimet e tij, «Kujtimet e një jeniceri»<sup>1)</sup>) Ja se ç'thotë ky bashkëkohës pak më i ri për Skënderbenë, duke bashkuar fakte dhe legjendë:

«Njëri vetëm që në gjendje t'i bëjë ballë atij (Sultan Muratit); ky qubej Skënder, i biri i Ivanit (Gjonit); atë e kishin futur që të ri midis jenicerëve të Sultan Muratit dhe ay mësoi te Sultani gjithshka mund të ishte në dobë të vendit të vet, duke qenë se gjonë favorin e Sultanit. Kur arriti ta bëjë këtë, i tha një herë Sultani: «Skënder, kérko prej meje cikin sundim do, unë do të ta jap.» Dhe ai kérkoi që t'i nepte tokën e Ivanit, pa thënë se ishte i biri i Ivanit (!) Slltani ja dha; ai e mori të gjithë, përvos qyteteve; pastaj duke i gënijer, i nxori jashtë jenicerët që tishin atje dhe i pushtoi qytetet»<sup>2)</sup>) Dhe më poshtë: «Pas dy vjet Sultan Murati vdiq në Adrianopojë nga mësi dhe mëria e madhe që vetëm Skënderit të Shqipërisë nuk mundi t'i marrë tokën dhe vendin Krujë. Sepse ky më përtvara kish qenë në oborrin e Sultanit, po pastaj ish shkëputur prej tij dhe mundi t'i qëndron...»<sup>3)</sup>

1) Jan Łoś, Pamiętniki Jana z Ostrowicy czyli kronika turecka Konstantego z Ostrowicy, Kraków 1912.

2) Llosh, Vepër e cituar, XXXIII, 1. 178-179.

3) Llosh, Vepër e cituar, XXIV, 1. 188.

I dyti është Donado da Lece (Lezze). Edhe pse nga pikëpamja e kohës është më i vonë (ay ka lindur më 1479), indikacionet e tija janë më të vjetra dhe me shumë rëndësi, sepse Da Lece ka përfshirë në tërësi në historinë e tij kujtimet e italianit Xhovani Maria Anxholelo (Angiolello), i cili kish rrojtur një kohë të gjatë në rrrethin e ngushtë të Sulltan Mehmetit II dhe e kish shoqëruar në ekspeditat e tija luttarake. Pas vdekjes së Mehmetit ai ishte kthyer më 1483 në Itali. Anxholelo dhe da Lece na thonë: «Duke qenë Murati në Adrianopojë i ardhi lajmi se subashi (qeveritari) i tij në Krujë kishte vdekur; dhe duke qenë se në oborrin e Muratit gjendej Skënderbeu, skllavi i tij, të cilin e kishin marrë si djalë nga Shqipëria dhe e kishin bërë turk; dhe duke qenë se ky ishte burrë i zoti dhe shërbëtor besnik i të zot, e mori këtë zyrë të vasalit të Krujës; dhe pasi iu dha ky hir, u nis dhe ardhi në sundim të Krujës; ai qëndroi besnik disa vjet, afro 2, duke u munduar të fitojë miqësinë dhe dashamirësinë e popullsisë së atjeshme dhe fshehurazi i bëri të ditur madhërisë së tij mbretit Alfons (të Napolit) se ishte dëshira e tij të ngrinte krye kundër turqve. . »<sup>1)</sup>

Një pikë tjeter ku Noli, në botimin që kemi përpara, është në kundërshtim me versionin e dhënë nga Barleti, është problemi i kthimit të Skënderbeut në stdhe. Sipas Nolit ky kthim nuk ka ndodhur n'atë formën e njohur, sepse Skënderbeu, thotë ai, ka qenë gjithmonë në Shqipëri, si vasal i sulltanit, në fëmijë e veli. Ajo që ka ndodhur me të vërtetë, sipas Nolit, është vetëm shkëputja e Skënderbeut nga ana e sulltanit, për tu lidhur me anën evropiane kundër turqve. Me këtë rast Noli hedh poshtë, si element të një «melodrami të keq», episodin e shtrëngimit të shkronjësit të sulltanit nga ana e Skënderbeut për thi dorëzuar fermarin, me anën e të cilit do të merrte qytetin e Krujës etj.

1) Donado da Lezze, *Historie turchesca*, edit. J. Ursu, Bucureşti 1916, f. 15-16.

Ç'thonë burimet për këtë pikë? Një shkrimtar i vetëm bashkëkohas i perëndimit, Volaterranus, pasi pranon se Skënderbeu u dorëzua peng në moshë 8 vjeç dhe u rrit në oborr të sulltanit, na thotë se sulltani vetë i dorëzoi Skënderbeut sundimin mbi tokat e tē jatit. Me këtë përputhet kronisti turk Ashik Pasha Zade, i cili vërteton se Skënderbeut ja kishte dhënë sulltani tokën e tij si timar (feud). Bashkë me këtë autor e jepin këtë të dhënë edhe kronistë të tjerë turq; si edhe Da Lece e Anxholeloja. Por vendimtare është dëshmia e dokumentit arkival kryesor, e regjistrat turk të tokave shqiptare të hartuar më 1431-1432<sup>1)</sup>, sipas të cilët Skënderbeu duhet të ketë ushtruar funksionin e qeveritarit turk në Krujë qysh përpara vitit 1438.

Nuk ka dyshim pra se kjo çështje duhet konsideruar si e zgjidhur tashmë në favor të tezës së Nolit. Por kjo nuk do të thotë nga ana tjetër se duhet të mohjmë si të paqena ngjarjet e vitit 1443, d.m.th. ikjen e Skënderbeut nga kampi turk i Nishit. Për këtë dëshmojnë mjaft qartë një burim perëndimor, «Chronica Ragusina»<sup>2)</sup>, në një lajm, që e ka vendin përpara luftës së Varnës, pra përpara 1444, se «Skënderbeu është futur prap në tokat e tē jatit» si dhe Halkokondili, kur na thotë se Skënderbeu prej pallatit të Sulltanit u arratis në atdheun e tij. Të njëjtën gjë e vërtetojnë kronistët turq që njohëm më sipër. Duke përfunduar këtë çështje, mund të themi se ikja e Skënderbeut nuk ishte as një gjë e veçuar, as e rallë. Të tilla raste kanë ndodhur me shumicë edhe në vëndet e tjera ballkanike.

Përfundojmë pra se, siç shihet, burimet lindore përputhen plotësisht me burimet perëndimore që suallëm më sipër për të vërtetuar versionin e vjetër të Marin Barletit për sa i përket dorëzimit të Skënderbeut si peng që në moshë të vogël dhe rritjes së tij në oorrin e Sulltanit. Ai duhet të jetë kthyer në atdhe i dërguar nga sulltani për atë qëllim, për të cilin ishte

1) H.Inalcik, Hicri 835 Suret-i Defter-i Sançak-i Arvanid, Ankara 1954; Historia e Shqipërisë, vell. I, Tiranë 1959, f. 271.

2) Chronica Ragusina Junii Resti, Zagreb; 1893, f. 290.

edukuar e pregetitur: d.m.th. për të administruar në vitet 30 të shek. XV si qeveritar turk vendet që kishte mbajtur deri atëhere i ati, Gjon Kastrioti, si vasal i sulltanit. Ndonëse arriti pozita të larta në radhët e feudalëve ushtarakë osmanë, nuk zgjati shumë dhe me rastin e parë Skënderbeu, i cili, siç e thotë qartë Da Lece dhe Anxholelo dhe më mirë akoma Barleti, nuk i kishte humbur lidhjet me popullin e vet, ngriti krye dhe u çkëput nga turqit, padyshim me rastin e luftës së Nishit.

3. — U tha qysh në fillim, se është merita e madhe e historianit Fan Noli që yuri në dukje se spiegi mi i asaj që është dukur e pabesueshme e përrallore në historinë e Skënderbeut duhet kërkuar në faktorin popull, i cili e bëri të mundur këtë luftë ngadhnjimtare **kundër forcave vigane të Sulltanëve**. Me këtë ai u ka dhënë përgjigjen më të qartë pikëpamjeve të shtrembëra të autorëve si Voigt, Jorga, Marinesko, etj., për të cilët lufta që zhvillohej në Shqipëri nuk paska qenë tjetër veç se një luftë «bandash» ose një luftë e paguar, e nxitur dhe e shtyrë nga shtete të jashtme si Napoli, Venediku ose Papati dhe udhëheqësi i saj, Skënderbeu, asgjë tjetër veç se një «kondotiere» i varur nga jasht.

Natyrisht e me të drejtë autori nuk mohon se në ngjarjet në Shqipëri ndikuan edhe faktorët e jashtëm ndërkombëtarë. E nuk mund të ishte ndryshe. Lufta që zhvillonte populli shqiptar kundër agresionit otoman ishte një pjesë e luftës së popujve veçanërisht të Evropës Juglindore kundër këtij rreziku; situatat që u krijuan me fitoret e këtyre popujve, e veçanërisht të popullit hungarez, do të ndikonin domosdo në mënyrë të favorshme edhe mbi zhvillimin e ngjarjeve në Shqipëri, ashtu si do të ndikonin në mënyrë negative vështirësitë që u krijuan nga politika e ngushtë, intrigante e drithëshkurtër e shteteve evropiane në lidhje me agresionin otoman. Fan Noli ka vënë gjithashtu mirë në dukje, se lufta që bënë shqiptarët nën Skënderbeun që një kontribut i rëndësishëm që dhanë ata për mbrojtjen e kulturës botërore. Në këtë kuptim mund të quhet me vend titulli «kampion i krishterimit» që i është dhënë

Skënderbeut, po të kuptohet me «krishterim» qytetëri-mi evropian i shek XV.

Duhet vënë në dukje si meritë e Fan Nolit që ai është shkëputur nga trädita e njohur, veçanërisht e historografisë italiane, për ta paraqitur Venedikun si strumbullar rrëth të cilat u organizua qëndresa që u zhvillua në Shqipëri. Noli ka ndjekur rezultatet e kërkimeve të historianit rus të shek. XIX, V.V. Makushef, të cilat dokumentojnë qartë politikën e egër grabitqare që zhvilluan në Shqipëri si në Dalmaci sunduesit venedikas në qytetet e pushtuara; ai ka treguar mirë se krahas robërimit që sillnin pushtuesit osmanë, nuk që i pakët edhe shfrytëzimi i shqiptarëve nga ana e «princave të parasë» të ardhur nga Venediku. Shumë qartë ka vënë Noli në dukje politikën e pabesë, plot intrigë sabotuese që ka zhvilluar politika venedikase në Shqipëri kundrejt Skënderbeut; ai nxjerr këndeja me të drejtë konkluzionin se në fakt Skënderbeut i është dashur të bënte të shumtën e kohës një luftë në dy fronte, kundër sultaniëve si dhe kundër republikës së Shën Markut (f. 105, f. 153).

Noli ka vënë gjithashtu në dukje se nuk ishin qëllime thjesht «altruiste» ato që e shtynin Alfonsin, mbretin e Napolit, për të ndihmuar Shqipërinë ose vetëm interesit për të penguar turqit të vendoseshin në bregun lindor të Adriatikut, prej nga mund të sulmonin lehtë, ashtu siç bënë më 1480, tokat napolitane të Apulisë; këtu vepron te padyshim edhe plani i një ekspansioni për të bashkuar në një dorë, në një perandori mesdhetare, tokat që nga Spanja lindore, Italia jugore, që i kishte në dorë tashmë Alfonsi, e deri në Ballkan e Konstantinopojë, për pushtimin e të cilave kryeurë duhej të bëhej Shqipëria (f. 50). Megjithatë Noli nuk ka vënë re se në marrëdhënjet shqiptaro-napolitane ka një ndryshim e një ndërprerje, që shfaqet qysh përpala vdekjes së Alfonsit (1458) e që spjegohet jo vetëm nga ndërlifikimet ndërkombëtare në Itali, po edhe nga fakti se lufta në Shqipëri kërkonte angazhimin e forcave të rëndësishme ushtarake, të cilat Alfonsi nuk ishte i gatshëm t'i epte. Më me rëndësi është akoma

një çështje tjetër. Dihet se me 1460 Skënderbeu dërgoi forcat e veta në Itali e më vonë shkoi edhe vetë, në ndihmë të birit të Alfonsit, Ferdinandit, kundër të cilit kishte shpërthyer një kryengritje. Në literaturë është spjeguar kjo ndërhyrje e shqiptarëve sikur Skënderbeu qe i detyruar ta bënte këtë në cilësinë e tij si vasal i mbretit të Napolit, spjegim të cilin Noli, heshtasi, duke mos i dhënë spjegim tjetër, len të kuptohet sikur e aprovon. Ndërkohë janë bërë të njohura materiale që na lejojnë ta hedhim poshtë një spjegim të tillë. Ne mund të themi me plot të drejtë se me ekspeditën e vitit 1460 Skënderbeu merrte iniciativën për të siguruar për luftën që bënte kundër pushtuesve mbështetjen politike-ushtarake të shteteve kryesore italiane, të cilët ishin aleate të Ferdinandit — d.m.th. të Papatit e të dukës së Milanos.<sup>1)</sup>

Një pikë tjetër e marrëdhënjeve ndërkombëtare të trajtuara nga F. Noli zgjon objeksione serioze nga ana e studjuesvet: është fjala për marrëdhënjet e Skënderbeut me Papatin. Nuk ka dyshim se, po të kemi parasysh rolin e rëndësinë e papatit në mesjetë si fuqi e madhe politike-ideologjike, fakti që për luftën kundër agresionit osman ishte interesuar edhe Roma, nuk kishte si të mos ushtronë një ndikim të rëndësishëm; ky faktor mund të përforconte pozitën politike dhe ushtarake të Skënderbeut jo vetëm në luftë kundër pushtuesve të huaj, po edhe kundër përçarjes e partikularizmit të feudalëve shqiptarë. Por tjetër është të konstatosh e të spjegosh këto fakte, e tjetër është të mbivlerësosh rolin e ndikimit të Papatit në luftën shqiptaro-turke, siq e bën F. Noli në disa raste.

Duhet thënë që në fillim se Fan Noli nuk e vlerëson drejt situatën reale të Shqipërisë në pikëpamje fetare në shek. XIV-XV; në kundërshtim me faktet, ai e mbivlerëson ndikimin e kishës katolike në Shqipëri, duke na thënë (f. 43) se «Shqipëria ishte kryesisht ka-

---

1) Shih për këtë: F. Pall, I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV, Napoli 1966, veçanërisht faqet 150, 196-197.

tolike...», se «feja katolike u jepte shqiptarëve atë unitet që nuk e kishin në pikëpamje shtetërore» etj. Pa dyshim këtu është lënë jashtë konsideratës se të paktën po aq e fuqishme ishte edhe kisha lindore, ortodokse; nga ana tjetër, në rrethanat e përçarjes fatare që sundonte në Shqipëri, politika militante e Papatit kundër «skizmatikëve të pabesë», siç e quante Roma kishën lindore, politikë e cila inkurajonte e përligjte çdo agresion e pushtim drejt vendeve të lindjes, midis tyre edhe të Shqipërisë, siç kishte ndodhur në kohën e normanëve, anzhuve etj, nuk mund të konsiderohet si politikë «bashkimi».

Fan Noli insiston disa herë mbi qëndrimin gjoja të sinqertë të papëve ndaj Skënderbeut. Do ta kërkonte arsyjeja të spjegoheshin shkaqet që i shtynin papët përkëtë qëndrim. Këtu nuk ishte fjala vetëm për interesin që kishte Roma të mbronte pozitat e veta, të fundit që mbante akoma në Ballkan, siç thotë Noli (f. 11/12) Një arsyе tjetër ishte se papët donin të shfrytëzonin situatën e vështirë në të cilën ndodheshin vendet e kishës lindore nën goditjet e pushtuesve osmanë, për t'ja nënshtuar këto vise sundimit të kishës katolike, përpjekje që çuan në «unionin», në të vërtetë në nënshtrimin e përkohshëm të kishës lindore në vitet 1439-1453. E më në fund politika e «kryqzatës» kundër turqve, që predikonte Roma u shërbente papëve për të nxjerrë të ardhura të reja nga popujt në formë taksash për kryqëzatën dhe për të larguar vemendjen e opinionit publik nga kritikat gjithmonë më të ashpra që po ngriheshin kundër Papatit e shfrytëzimit të rëndë që ushtron të ai në vendet e ndryshme — një paralajmërim i «Reformës» që do të shpërthente në Evropën e Mesme e Perëndimore.

Në këto kushte ishte e qartë se premtimet që i jep-te Papati Skënderbeut nuk ishin as reale, as edhe të sinqerta, ashtu si ato që u kishte dhënë perandorëve të Bizantit përpara rënjes së Konstantinopojës më 1453. Fan Noli insiston në rëndësinë e këtyre ndihmave dhe kënaqet të na japë disa herë edhe shifra (si p.sh. në f. 48). Nuk po krahasojmë vlerën

reale të këtyre ndihmave, që në të vërtetë nuk mjaf-tonin as për të mbajtur njëqind ushtarë me rrrogë për një kohë më të gjatë se një vit; kritikën më të mirë politikës egoiste, dritëshkurtër dhe dredharake të Papatit, dhe me këtë edhe paraqitjes së saj nga ana e F. Nolit, e ka bërë vetë Heroi ynë. Mjafton të citojmë këtu dy dokumenta që flasin qartë se si e vlerësonte Skënderbeu «ndihmën» që i jepnin papët, për t'u bindur për këtë. Pikërisht në vitin 1467, ahore kur Shqipëria ndodhej në kushte shumë të vështira, pas ekspeditës rrenimqare të Mehmetit II kundër Krugjës, Heroi ynë vajti vetë në Romë, për të nxjerrë nga Pavli II diçka më tepër se bekime apostolike e mburrje panegjirike. Por i lodhur nga një pritje e gjatë edhe e kotë dhe nga premtimi boshe, ai u nis nga Roma me 14 shkurt 1467, «i dëshpëruar» siç thotë dokumenti, sepse «s'ka marrë nga papa asnjë grosh... Me përqeshje ai (Skënderbeu) i tha dje një kardinali — kështu raporton një vëzhgues diplomatik — se tani e tutje ai donte të bënte luftë kundër kishës e jo kundër turkut». Dhe si përfundim të vizitës së tij tek papa, Skënderbeu deklaronte se «nuk besonte që mund të gjindej mizori më e madhe në botë se sa te këta priftërinj»<sup>1)</sup>

\* \* \*

Nuk do të thotë të nënvleftësosh punën e historianit F.S. Noli, në qoftë se ne u përqëndruam në një varg pikash që zgjojnë vërejtje e obiekione dhe që, pas mendimit tonë, duhen pasur parasysh në leximin e librit që po i jepet sot lexuesit shqiptar. Është e vërtetë se «Historia e Skënderbeut» e vitit 1947 ende nuk mund të quhet një vepër që mund të kënaqë plotësisht kërkesat shkencore si edhe ato të masave të gjëra të inteligjencës sonë të re. Do të duhet një shqyrtim i ri, i gjithanshëm e i peshuar, i gjithë materialit burimor, edhe i atij që ka dalë në dritë në këto 20

---

1) Shih F. Pall, vepër e cituar f. 216-217.

vjet që nga botimi i librit të F. Nolit, do të duhet një interpretim me pikëpamje metodologjike shkencore të shëndosha, për ta paraqitur në dritën e plotë e të drejtë figurën e heroit tonë kombëtar dhe epokën e tij, një nga periudhat më të rëndësishme të historisë sonë. Por edhe me këto vërejtje, vepra e Fan S. Nolit që kemi përpara ka meritën se shtron rishtas për studim problemin e Skënderbeut, në një plan të ri, më të ngri-  
tur, me pikëpamje më të përparuara. Dhe kjo përbën një meritë jo të vogël në vargun e meritave që i ka njojur me të drejtë historia e kulturës shqiptare poe-  
tit e patriotit, historianit e mendimtarit tonë të shquar,  
Fan S. Nolit. ?

4

2 Aleks Buda

Tiranë, Tetor 1967.

## HYRJE

Çdo heroi në histori i është dashur të kalojë përmes tri fazave të glorifikimit, të asgjësimit dhe të rivlerësimit. Kjo do të thotë se, në fillim, ai është ngritur në qiell prej admiruesvet të tij; se pastaj është dërmuar në mënyrë të pamëshirëshme prej kritikuesvet të tij; se, më në fund, është nxjerrë përsëri në shesh, nga varri, dhe me durim, me mundim dhe me mëshirë është vënë në vendin që i takonte prej historianëvet të arësyeshëm, që s'kanë qenë verbuar as prej fanatizmit të admiruesvet të heroit, as prej tërbimit të kritikuesvet të tij.

Skënderbeu nuk i ka shpëtuar këtij rregulli të përgjithshëm. Dhe pyetja, pra, është kjo: ç'mbetet prej tij, pasi që kritika historike ka bërë çmos për ta vrarë dhe për ta ngjallë? Ose, duke shkuar edhe më larg, a është vallë historia e Skënderbeut një mit apo një fakt historik? Ky është problemi i parë për t'u zgjidhur në rastin e tij, si dhe në atë të çdo heroi tjetër, që ka kaluar nga historia prozaike në legjendën poetike.

Historia e Skënderbeut është një tregim i pabesueshëm, ashtu si çdo legjendë. Me gjithë këtë, ujo mund të shkruhet në një prozë të thjeshtë dhe të pastolisur, ashtu si dhe çdo tregim tjetër i kohës së tij. Dy historianë shqiptarë, Tivarasi, ose Anonimi i Tivarit, dhe Marin Barleti prej Shkodre, kanë shkrojtur biografi të gjata dhe të hollësishme të heroit. Pa pikë dyshimi, ata janë panegjiristë, por historia e tyre mund të kontrollohet, të ndreqet e të plotësohet me shkrimet e historianëvet bashkëkohës italianë, bizantinë e turq, si dhe me burimet e arkivave që kemi në dorë tani.

Historianët kritikë në përgjithësi pretendojnë se më të shumtata e fitoreve të Skënderbeut kanë qenë pak a shumë të zmadhuara prej biografëve të tij, gjë që është e vërtetë deri në një farë pike; por pastaj hidhen në përfundimin se gjithë historia e Skënderbeut është një ballon i fryrë, gjë që është krejtësisht e gabuar. Duket se ata harrojnë që pika kryesore në historinë e Skënderbeut është një fakt historik, mbi të cilin, sidogoftë, s'do duhej të kishte as pikën e dyshimit. Më 1443 Skënderbeu shtiu në dorë kështjellën e Krujës dhe e mbrojti vazhdimisht, kundër Muratit II (1421-1451) dhe Mehmetit II (1451-1480)<sup>1</sup>), për një çerek shekulli. Kruja ra vetëm më 1478, dhjetë vjet pas vdekjes së Skënderbeut<sup>2</sup>). Si pasojë, problemi kryesor në karierën e Skënderbeut është ky: A kanë bërë Murati II dhe Mehmeti II, njeri pas tjetrit, ndonjë përpjekje serioze për ta pushtuar Krujën, dhe a kanë qenë ata çdo herë të shtrënguar prej Skënderbeut të heqin dorë prej rrethimit e të tërhiqen? Po t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje në mënyrë pohuese, dhe po të jenë fakte të vërtetuara këto ekspedita të mëdha e të udhëhequra personalisht prej dy sulltanësh të mëdhenj, atëherë çdo gjë tjetër bëhet e një rëndësie të dytë. Zmadhimet e biografëvet të Skënderbeut u takojnë vetëm hollësirave të dyta, dhe këto hollësira nuk e lëkundin aspak faktin qendror, domethënë që Sulltanët dështuar në përpjekjet e tyre për ta mundur Skënderbeun dhe për ta shtënë në dorë kështjellën e tij. Ky është, në bërthamën e tij, problemi qendror i historisë së Skënderbeut. Megjithatë, problemi i ngadhnjimeve të tjera të Skënderbeut s'duhet t'u shpëtojë syve tanë; në rast se këto fitore mund të vërtetohen në mënyrë të qartë, atëherë besueshmëria e biografëve të tij është e siguruar.

1) Ndryshe nga arabët, turqit e përdorin emrin «Mohamed» vetëm për Profitin e Islamit dhe përdorin emrin «Mehmed» si emër të përvetshëm për muslimanët, po ortografia është e njëjtë; ndryshon vetëm shqiptimi.

2) Krh. Bibliografinë.

Në rast se nuk tregohet në mënyrën e duhur, luf-  
ta e pabarabartë e Skënderbeut dhe e krahinës së tij  
të vogël malore kundër dy sulltanëve nga më të më-  
dhenjtë e Perandorisë Otomane që po ngrihej, kishte  
për të tingëlluar si një duel përrallor midis një Davidi  
të vogël të rreckosur dhe dy Goliathëve të veshur krej-  
tësisht me hekur. Prandaj duhet të kemi kujdes të tre-  
gojmë mirë se Skënderbeu nuk ka qenë fill' i vetëm  
në luftën e tij epike, por ka qenë përkrahur nga faktorë  
të fuqishëm, të tillë si Papati, Mbretëria e Napo-  
lit, Republika e Venedikut, Qyteti i Raguzës, me një  
fjalë, nga e tërë bota katolike romane, çështjen e së  
cilës ai e mbronte në Ballkan. Këtyre duhet t'u shtoj-  
më edhe faktorët gjeografikë, shoqërorë dhe ekonomikë  
që vepronin në dobi të Skënderbeut, dhe, më në fund,  
shqiptarët vetë, të cilët qëndruan me të deri në pikën  
e fundit. Çdo faktor përbën një problem në velvete dhe  
meriton të studjohet veçanërisht. Problemi për të gjet-  
tur se cili ka qenë, në rast se ka qenë faktori vendimtar,  
do të mbetet gjithëmonë i pazgjidhur. Por të gjithë  
së bashku do të ndihmojnë për të spjeguar kari-  
erën e shkëlqyer të Skënderbeut. Kuptohet pa e thënë  
se faktorët shoqërorë dhe ekonomikë kanë qenë atëhere,  
ashtu siç janë gjithmonë, në rrënjet e gjithë punëvet.

Taktika ushtarake e Skënderbeut ka qenë ajo e luf-  
tës së çetave në mal: Pra, pyetja që duhet bërë është  
kjo: ku e mësoi ai zanatin e tij kaq mirë, sa të ishte  
i zoti të ndalonte me këtë armë primitive dy nga sull-  
tanët më të mëdhenj? Mos vallë në malet, ku kish li-  
ndur, apo në pallatin e Sulltanit, ashtu siç e thonë  
gojëdhënët? Ky problem i rëndësishëm, që është enig-  
ma e parë, së cilës duhet t'i bëjë ballë historiani, ose  
është kapérxyer ose është trajtuar në mënyrë të përciptë.

Disa historianë e kanë pranuar legjendën rreth  
fëmijërisë së Skënderbeut; kurse disa të tjerë kanë  
shprehur dyshime sepse legjenda kundërshtohet prej  
aritmetikës dhe kronologjisë. Por askush nuk e ka the-  
lluar në mënyrë të mjaftueshme çështjen, për t'i gje-

tur një rrugëdalje këtij fillimi përrallor. Ky problem do të bisedohet më gjatë atje ku e ka vendin. Këtu mjafton të thuhet se gojëdhëna është e papranueshme për më tepër se një arësy. Ajo duhet ose të hidhet poshtë krejtësisht ose të ndryshohet rrënjosht. Sidoqoftë, problemit nuk duhet dhe nuk mund t'i shkohet rrotull. Përndryshe, krejt biografia e Skënderbeut do të ndertohej mbi rërë.

Autorët e dy volumeve monumentale të veprës «Acta et Diplomata Albaniae» mendonin të botonin edhe tri vëllime të tjera, me qëllim që të përfshinin periudhën e viteve 1407-1471, e cila përputhet me kohën e jetës së Skënderbeut. Lufta e Parë Botërore u dha fund punimeve të tyre. Më 1916 njeri nga të tre dijetarët, hungarezi Ludvig fon Taloci (Ludwig von Thalloczy), gjeti vdekjen në një ndeshje trenash; më 1918 vdiq çeku Konstantin Jireček; dhe, më në fund, kroati Milan fon Shuflaj (von Sufflay) u vra prej një fanatiku serb. Me vdekjen e këtij të fundit u varrosën jo vetëm të tri volumet e pabotuara të veprës «Acta», por edhe një «Histori e Shqipërisë», që ai ishte duke shkrojtur. Vetëm një kapitull i kësaj të fundit i shpëtoi katastrofës, ai që është botuar në «Illyrisch-Albanische Forschungen». Gjithë kjo punë e madhe duhet të bëhet përsëri. Po ashtu, detyra e të shkrojturit të historisë së Skënderbeut është ngatërruar tashti prej faktit se burimet janë shpërndarë në katër anët e botës dhe duhet të gjënden e të mblidhen përsëri. Disa prej librave nuk gjënden në Shtetet e Bashkuara. Disa prej atyre që gjënden, nuk ndodhen në Boston ose në Kembrixh (Cambridge). Duhet të bësh një udhëtim në qytetin e Nju-Jorkut për të gjetur veprën e Saad-eddinit «Kurora e Historive» në gjuhën turqishte, si dhe për katër vepra të tjera shumë më të rëndësishme. «Historia e Shkurtër e Shqipërisë» e Jorgës, në gjuhën frengjishte, gjendet vetëm në Uashington, D. C. Përfat të mirë, Biblioteka e Kongresit është aq zemërgjerë, sa t'ja japë hua këtë libër bibliotekave të tjera, me kërkesën e këtyre, për një kohë të shkurtër. Me

gjithë këto pengesa që hasëm, gjetëm një material të mjaftueshëm për të përligjur një libër të ri mbi Skënderbenë.

Problemi i marrjes së librit të një biblioteke me qëllim konsultimi nuk është gjithmonë i thjeshtë. Ka mundësi që këtë të jetë duke e përdorur dikush tjetër ose, ca më keq, që ndonjë djalosh i papjekur ta ketë humbur përkohësisht librin, ose që ky të mos jetë kurrë në vendin e vet, kështuqë të duhen kërkime të gjata për ta kthyer librin në bazë. Mësimi për t'u nxjerrë nga kjo përvojë e hidhur ka qenë që të kopjohej çdo gjë në lidhje me subjektin para se libri t'i kthehej djaloshit të pakujdeshëm dhe të hiqej përgjithëmonë nga qarkullimi. U deshën muaj të tërë për të bërë këtë punë kopjimi. Por prej kësaj pune deri te një shtojcë, që do t'i bënte konsultimet më të lehta si për autorin, ashtu dhe për lexuesin, mbetej vetëm një hap për t'u hedhur. Shtojca ideale kishte për të qenë ajo që do të përbante çdo dokument të rëndësishëm që ka të bëjë me Skënderbenë. Kjo nuk mund të bëhet, sepse do të duhej një vëllim i veçantë. Kështu u desh që shtojca të shkurtohej deri në një përbledhje të vogël materialesh që kanë qenë lënë pas dore ose që meritojnë të theksohen më shumë.

Historia e Skënderbeut është interesante nga katër pikëpamje të ndryshme: si një kryqëzatë kristiane kundër turqve; si një luftë klase e fshatarësise së lirë shqiptare kundër feudalizmit turk, nga njera anë, dhe kundër kapitalizmit venedikas, nga ana tjetër; si një luftë e gjatë rezistence kundër dy sulltanëve më të mëdhenj të turqve; dhe, më në fund, si një kapitull shumë i rëndësishëm i historisë së Gadishullit Ballkanik. Ajo meriton të tregohet përsëri në gjuhën inglishtë, pasi libri i Murit (Moor) mbi këtë temë, i shkruar rreth një shekulli më parë, është vjetruar. Ky libër kishte për qëllim ta plotësonte këtë mungesë. E parashtruar në fillim si një disertacion për titullin e doktorit të filozofisë të Universitetit të Bostonit, vepra tani është përpunuar për publikun e gjerë, duke

shtuar burimet, punimet e dijetarëve të tjerë, bibliografinë, shtojcën, shënimet, të cilat janë vënë në fund të librit<sup>1</sup>), ku mund të konsultohen prej atyre që kanë nevojë, pa shqetësuar lexuesin e mesëm.

Përfitoj nga ky rast për t'u shprehur botërisht falenderimet e mia profesorit Uorren Olt (Warren Ault) dhe profesorit Frank Novak (Nowak), që kanë lexuar këtë libër dhe më kanë ndihmuar me vërejtjet e tyre.

Boston, Mass.  
më 7 shkurt 1946.

F. S. Noli

---

1) Në botimin original anglisht (sh. i red.)

## KAPITULLI I

### S F O N D I

Katoni, që ishte plebe, mendonte se luftërat bëhen prej popujvet, domethënë se meritën e luftimit e kanë këta dhe jo komandantët e tyre. Si rrjedhim, ai shkrojti një histori të Romës, në të cilën nuk përmendej asnjë emër komandanti, dhe i vetmi emër që figuronte në historinë e tij ishte ai i një elefanti<sup>(1)</sup>. Katoni e tepëron, kur i konsideron komandantët si kuklla të thjeshta, por sigurisht ai nuk gabohet, kur na e kujton se kush e bën punën e vërtetë dhe kujt duhet t'i takojnë nderi i vërtetë në zhvillimin e luftrave dhe në arritjen e fitoreve. Dhe, me të vërtetë, fjala e tij është ilustruar fare bukur prej kryqëzatës së Skënderbeut. Gjatë luftës së një populli, ishte krejt e natyrëshme që shqiptarët të bënин mrekullira nën një komandant të lindur, që personifikonte rrymën e popullit. Një kombinim faktorësh të ndryshëm i bëri shqiptarët të aftë për të luftuar në një nga luftërat më heroike të historisë, në një kohë kur të gjithë rrotull tyre, bizantinët, bullgarët, serbët dhe grekët, kishin rënë përbys përpëra ngadhnjmëtarit turk<sup>(2)</sup>.

Shqiptarët janë stërnipërit e ilirëvet të vjetër<sup>(3)</sup>,

1) Thompson, Vëll. I, fajet 64-65.

2) Fallmerayer, Vëll. VIII, f. 710.

3) Thalloczy, «Forschungen», Vëll. I, f. 8; Jireček, «Forschungen», Vëll. I, f. 64. «Ilirishtja është gjuhë Satem...» Jokl, «Illyrier», Vëll. VI, f. 38. «Shqipja është gjuhë Satem... Lidhje të njëllojta gjejmë në ilirishten...» Jokl, «Albaner», Vëll. I, f. 89. «Shqipja është e një gjinie të afërt si me ilirishten ashtu dhe me thrakishten», po aty, f. 91.

ardhësit e parë indo-europeanë në bregun lindor të detit Adriatik, që prej Venedikut të Italisë në veri e deri te Akarnania e Greqisë në jug. Emri i tyre rrjedh nga ai i fisit ilirian të albanëve, të përmendur për herën e parë prej Ptolomeut në shekullin e dytë pas Krishtit<sup>(4)</sup>.

Ata banonin vendin që është sot Shqipëria qendrore dhe atë që ishte vetë Shqipëria deri në shekullin XV. Më vonë emri u përhap dhe përfshiu gjithë fiset iliriane fqinjë. Aleksandri i Madh i karakterizon ilirianët dhe thrakasit si më të guximshmit dhe më luftëtarët e gjithë europianëvet<sup>(5)</sup>. Si rrjedhim, albanët duhet të kenë qenë më të fortët e kësaj race, pasi ata arritën të jetojnë edhe pas shëmbjes së imperializmit romak, sllav e bizantin.

Krishtërimi u përhap në Shqipëri prej misionarësh të Romës. Pothuaj se gjithë termat kishtare në gjuhën shqipe rrjedhin nga latinishtja.<sup>(6)</sup> Si një pjesë e Ilirisë (Illyricum), Shqipëria i përkiste Selisë së Shenjtë të Romës deri sa Leoni I Izauriani e shkëputi atë nga Roma më 734 dhe ja fali Patrikanës Greke. Ndërkohë, bullgarët dhe serbët u futën si një pykë përmes Maqedonisë deri në Selanik dhe nuk e lanë Patrikanën Greke që ta shtinte në dorë Shqipërinë në mënyrë të qëndrueshme. Kryqëzatat bënë që të humbisnin pothuajse krejtësisht gjithë fitimet e arritura prej patrikëve bizantinë, të cilët përbëheshin nga tri pyka ndërhyrëse greko — ortodokse; njëra në jug nga Janina në Vlorë; e dyta — nga Ohri në Krujë; dhe e treta — nga Peja në Shkodër e Tivar<sup>(7)</sup>. Por këto pyka ishin mjaft të dobëta dhe, dalëngadalë, u tërhogën ose u zhdukën krejtësisht. Në shekullin XV Shqi-

4) Jirecek, «Forschungen», Vol. I, f. 66.

5) Arrianus, Flavius, «Anabasis Alexandri», tekost grek me një përkthim inglisht të F. Iliff Robsonit, Biblioteka Klasike e Loebit, New York, Putnam, 1929, në dy vëllime, vell. I, Libri II, kapitulli 7, faqe 149.

6) **Mesha** nga missam; **Shënji** nga sanctum; **Altari** nga altarem, **Kreshma** nga quadragesiman; **Kërshëndella** nga Christi Natalia; **Kryqi** nga crucem; etj.

7) Syfflay, «Kirchenzustände» (Gjëndja e kishëve) në Forchungen, f. 189.

përia ishte në shumicën e saj katolike romane me tetëmbëdhjetë seli peshkopale; disa prej këtyre kanë një histori të pandërprerë që prej agimit të Krishtërit e deri në ditët e sotme<sup>(8)</sup>. Çdo peshkop ishte një mbledhës fondesh për kryqëzatën e Skënderbeut; çdo kallogjer ishte një agjent propagandist i tij<sup>(9)</sup>. Feja u dha shqiptarëve unitetin që u mungonte si shtet. Feja ka shërbyer po ashtu edhe si një lidhje për t'i bashkuar me Perëndimin.

Shqipëria është e ndarë pothuajse në tri zona të pabarabarta: fushat e ulëta të bregdetit me një klimë mesdhetare, të mbuluara me ullishta; prapa, malësia e egër me një klimë alpine, e mbushur me arinj dhe ujqër; dhe, në qendër, në brendësi të vendit, krahinat kodrinore, me kullota të gjelbëruara. Është një amfiteatër i shtrirë në drejtim të detit Adriatik, me male skërkaskërka që mbulojnë pothuajse tre të katërtat e sipërfaqes dhe që formojnë një si ledh që pengon hyrjen në tokat e ulëta. Lumenj të rrëmbyeshëm dhe të tërthortë turren prej malësisë në drejtim të detit, duke lënë në hinterlandin malor një labirint majash të ngitura posa kështjella, me gryka të ngushta si kurthe dhe me lugina të shkreta. Është sigurisht një nga tokat më të vështira të kontinentit europjan. Analisti turk, Uruxi, i cili duhet t'i ketë parë këto male, i përshkruan si të pakalueshme, qoftë edhe për sorrat; të kalueshme vetëm për djajtë (*iblis*), ashtu siç janë shqiptarët<sup>(10)</sup>. Kjo ishte një tokë ideale për luftën e çetave të Skënderbeut<sup>(11)</sup>.

Në Shqipërinë e Skënderbeut kishte tri klasa shogërore: fshatarët e lirë të malësive dhe të kodrave, tre-

---

8) Farlati, Vëll. VII, f. IX-XIV; Jirecek, «Handelsstrassen», f. 16.

9) Theiner, «Monumenta Slavorum», Vëll. I, Nr. DOVI, f. 427-8; Sht. Nr. 15.

10) Uruxh, «Frühosmanische Jahrbücher», f. 137.

11) Barbarich, f. 192.

gëtarët e qyteteve të lulëzuara të bregdetit<sup>(12)</sup>, dhe aristokratët e vegjël ose, më mirë, krerët e fiseve patriarchale te malësive. Disa prej aristokratëve lëkundeshin dhe, ngandonjëherë, kalonin në anën e armikut, por më të shumtën bënин çështje të përbashkët me dy klasat e tjera. Ata urrenin me gjithë shpirt sundimin turk. Ata donin të mbeteshin të lirë. Bujkrobëria dhe skllavëria ishin gjëra që s'mund të duroheshin kurrë prej tyre. Ashtu siç e thotë Makushevi, shqiptari nuk mund të bëhej skllav<sup>(13)</sup>. Në tregjet e skllevërvet të Turqisë, s'kishte për të blerë shqiptarë ose hungarezë, sepse këta nuk mund t'i vinin në punë dhe ishin tepër të rrezikshëm për zotërit e tyre.<sup>(14)</sup> Falmerajeri ka të drejtë kur i quan ata dashnorë fanaticë të lirisë<sup>(15)</sup>. Turkofili Kritobul (Critoboulos) e vërteton këtë gjë: Sa të binin në duart e turqve, ata hidheshin që nga shkëmbinjtë në greminë, duke dashur më fort vdekjen se skllavërimin<sup>(16)</sup>.

Me përjashtim të Kritobulit, gjithë historianët e tjerë po hojnë njëzëri se malësorë shqiptarë kanë refuzuar t'i paguanin haraq Turkut. Analisti turk Uruxh e thotë

12) «Hyrjen në këtë tokë (të Shqipërisë) e bëjnë të mundur, përveç skeleve të qyteteve bregdetare, sidomos grykat e lumenjvet, dhe tregëtarët e kohës mesjetare vizitonin jo vetëm Buenën, në të cilën lundrohet edhe sot, dhe Drinin, por edhe Matin, Ishmin, Vregun (Shkumbinin), Devollin (Semanin) dhe Vijosën. Këta kanë qenë Fluminaria, fiumane de l'Albano, nëpër të cilat lulëzonte një tregëti e rëndësishme drithërash, sidomos në Vreg dhe Devoll; bregdeti i rrafshët shqiptar, që tanë është krejt i shkretuar, atëhere ishte i mbuluar me të korrura të begatëshme...» Jirecek, «Handelsstrassen», faqe 63.

13) «Albanec ne mog byt rabom» (Shqiptari nuk mund të bëhej rob), Makushev, «Razyskania», f. 122.

14) «Dhe vërtet, asnjë fis, asnjë kategori skllevërish nuk gjëne blerës më me vështirësi se sa epirotët dhe hungarezët, pasi thonë se këta nuk janë fare të përshtatshëm për shërbim, janë tepër të rreptë dhe kurrë nuk kanë pasur zakon të bëhen turq të mirë.» Barleti «Vita», Libri VIII, f. 239.

15) «Populli fanatic për liri». Fallmerayer, Vell. VIII, f. 666.

16) «Disa nga ilirët, duke parë se po ndiqeshin këmba-këmbës prej hoplitëve dhe duke mos ditur se ku të shpëtonin kokën, u hodhën në greminë nga shkëmbinjtë dhe u vranë». Kritobili frangjisht, Libri V; par. 71; Sht. Nr. 54.

këtë në një formë lakonike: «Ata s'i paguanin tribut askujt!»<sup>(17)</sup> Kritobuli na jep një arësye ekonomike bindëse: «Ata nuk kishin para»<sup>(18)</sup>. Dhe kjo ishte e vërtetë për shumicën dërmuese të popullsisë, e cila merrej me bujqësi ose me blegtori dhe s'kishte arritur akoma fazën e ekonomisë monetare. Ngandonjëherë, kur shtrëngoheshin fort prej sultani, vazhdon të thotë Kritobuli, «shqiptarët mbase premtonin të paguanin haraç, si të tjerët, por ndërronin mendje shumë shpejt dhe ktheheshin në qëndrimin e tyre kryengritës të patundur»<sup>(19)</sup>. Me fjalë të tjera, e vetmja gjë që ata mund të bënin, ishte të jepnin një premtim ose një haraç nominal, po sa për haraç të vërtetë në të holla ose në natyrë, ky ishte jashtë çdo bisedimi.

Skënderbeu nuk ka qenë një fenomen i veçuar në Shqipëri. Të tjerë, përpara tij, kishin arritur t'i bashkë-nin fshatarët shqiptarë kundër sundimit të huaj dhe të gjithë pa përjashtim u qenë drejtuar në radhë të parë papëve për të kërkuar përkrahjen e tyre, dhe papët kishin qenë gjithmonë të kënaqur t'u ndihmonin. Është gjë mjaft e çuditëshme që gjithë udhëheqësit vini nga vendet e pykave greko-ortodokse që papët kanë dashur t'i aneksojnë: Balshajt nga pyka e Pejë-Shkodër-Tivat, Kastriotët dhe Topiajt — nga pyka e Ohër-Krujës, Muzakët, Shpatajt e Buajt — nga pyka e Janinë-Vlorës.

Balsha I dhe të tre bijtë e tij, Strazimiri. Gjergji dhe Balsha i Vogël, ngritën krye fill pas vdekjes së Car Dushanit dhe arritën ta bashkonin Shqipërinë, që nga

17) «Kimseye kharatch vermezler». Uruxh, «Frühosmanische, Jahr bücher», page 137.

18) «Car ils n'avaient pas d'argent». Kritobuli frengjisht, Libri III, par. 97. f. 240; Sht. Nr. 54.

19) «Edhe më përpara, Sulltan Murati, i ati i sulltanit të sotëm, i pat luftuar me një ushtri të madhe dhe me forca të rëndësishme... Me gjithë këtë, ai s'kish mundur ta pushtonte dhe ta nënshtronte plotësisht vendin. Vetëm se kishte lidhur me ta një marrëveshje, sipas së cilës ata do t'i paguanin një farë haraçi të përvitshëm... Ata i qëndruan marrëveshjes për pak kohë; por, shpejt e shkelën, nuk paguan haraçin dhe, me sulme të shpeshta, u ranë anë e mbanë tokave të Sulltanit dhe i dëmtuan». Kritobuli frengjisht, Libri III par. 93; Sht. 54.

Tivari gjer në Gjirokastër në perëndim, që nga Gjirokastra gjer në Kostur në jug; që nga Kosturi gjer në Ohër e Prizren në lindje dhe që nga Prizreni gjer në Shkodër e Tivar në veri. Ata bile e zgjeruan kufirin e tyre verior deri te fusha e Narentës, nën Raguzë, dhe sunduan mbi një vend dy herë më të madh se Shqipëria e sotme. Suksesi i tyre shpjegohet kryesisht me faktin se ata u shkëputën nga kisha greko-ortodokse dhe u bashkuan me kishën katolike të Romës në vitin 1368, duke u identifikuar kështu me Shqipërinë katolike romane<sup>(20)</sup>. Bashkimi shqiptar, nën Balshajt, zgjati deri në vitin 1379, kur vdiq Gjergji I, më i madhi i dinastisë. Pastaj erdhën turqit, dhe Balshajt u dërmuan midis mokrave venedikase dhe turke. Venediku i përkrahu Balshajt derisa ata e shporrën zgjedhën serbe. Por ai u ra me thikë në shpinë, kur ata u bënë tepër të rrezikshëm për perandorinë e tij në Adriatik. Në kohën e Skënderbeut, Balshajt u katandisën të zotëronin vetëm një copë të vogël toke midis Lezhës dhe Shkodrës, që ka qenë prona e tyre e parë<sup>(21)</sup>. Skënderbeu pretendonte se ish mprojtësi dhe trashëgimtari i tyre<sup>(22)</sup>.

Lufta e çlirimt nga zgjedha serbe u bë në Shqipërinë e jugut prej Gjin Bua Shpatës nga Arta (viti 1400). Edhe ky i shtriu kufitë e sundimit të tij në drejtim të jugut, përtej Etolisë dhe Akarnanisë. Dhe pi-

20) Theiner, «Monumenta Slavorum», Vëll. I, faqet 261-263.

21) «Një nga fisnikët e Shqipërisë me mbiemërin Balsha... Orbi mi ka thënë se ky kishte dalë nga fisnikët vendas të Shqipërisë». Dy Kanzh (Du Cange), faqe 266. «Si i afërt (i Balshajve) del një shqiptar, vojvodë Nikollë Zaharia, Zot i Buduas». Jireček, «Serben»; I, f. 425, «Zoti i Shqipërisë së Veriut, Gjergji II Balsha», Sufflay, «Forschungen», Vëll. I, faqe 298. «Shqiptar katolik-roman, Gjergj II Strazimirov Balsha». Gelcich, «Balscidi» faqe 187; krh. Gelcich, «Cattaro», faqe 135; «Acta Albaniae», Vëll. II, viti 1396, Nr. 548, fq. 146; Fallmerayer, Vëll. VIII, f. 691... «Balsha plaku, pushtuesi i ri gegë, nga Shqipëria e veriut». Po aty, f. 693: «Por, kur tregojnë kronikat e vjetra se Gjergj Balsha hyri në Banat me 10.000 burra dhe e shkretoi me egërsi shqiptare, këtu nuk duhet të mendojmë për të ashtuquajturin Banat te Temeshvarit të sotëm».

22) Kronika e Magnos, te Jorga, «Notes», Vëll. III faqe 191, notë 1: «Brenda tri ditëve, pushtoi vende të tjera në Shqipëri dhe u bë i fuqishëm, duke thënë se ishte trashëgimtari i Balshës».

kërisht në kohën, kur Gjergji I Balsha i dërmonte boshnjakët në Banat, më 1379, Gjin Bua Shpata korri një fitore të shkëlqyer mbi ushtritë e bashkuara të serbëve, të grekëve dhe të napolitanëve, dhe i detyroi këta ta ngrinin rrëthimin e Artës, kryeqytetit të tij. Taktika që përdori u përsërit herë pas here prej Skënderbeut në rrëthimet e Krujës në vitin 1450 dhe në vitet 1466 - 67 (23).

Gjin Bua dhe Pjetër Ljosha (24) me kalorësinë e tyre të lehtë e mundën Niqeforin II, sunduesin e Epirit dhe të Thesalisë, në betejën e Akeloosit, në vitin 1358. Kjo ishte një luftë e vërtetë klasash. Niqefori II, në krye të një ushtrie grekësh dhe mercenarësh turq selçukë, deshi të rizaptonte çifliqet e zotëruara nga çifligarët bizantinë, të shpronësuar nga malësorët shqiptarë (që ishin mërguar në Greqi qysh në fillim të shekullit XIV, sipas Kantakuzenit) (25). Kjo luftë klasash spjegon urrejtjen e egër të aristokracisë bizantine kundra fshatarëvet shqiptarë katolikë romanë, ashtu siç provohet me shembujt e shkrimeve të Franzës, Dukës, Laonik Halkondillës dhe Kritobulit.

Një paraardhës tjeter i dëgjuar ka qenë edhe Gjergj Aranit Topia Komneni (v. 1461), vjehri i Skënderbeut. Ai ka qenë i pari që i dha, më 1433, një goditje dërmuese një ushtrie turke nën komandën e Ali Bej Evrenozit, të cilën kishte arritur ta shtinte në kurth e ta bënte copë-copë në grykat akroceraniane të Kurveleshit. Kjo fitore e bëri atë të famshëm në tërë Europën. Papa Eugjeni IV (26), Alfonsi V i Napolit dhe Perandori

23) Fallmerayer, Vëll. VIII, faqe 704.

24) Po aty, f. 676.

25) «Grekët qenë kudo pér pasardhësin e princërvet të vjetër të vendit, kurse shqiptarët qenë kundër tij. Niqefori donte, me një rivendosje të përdhuntë, t'i kthente çifliqet në gjendjen që kishin qenë tetë vjet më parë... Por pasoi shpejt një kryengritje e shqiptarëve. Despoti Niqefor, me «stratiotët» e tij grekë dhe me mercenarët turq, u mund dhe u vra në lumin Akeloos (Aspropotamos) prej fisnikëve shqiptarë me ushtarët e tyre shumë të lëvizshëm», (1358, Kantakuzeni IV, kap. 43). Jereçek, «Serben», Vëll. I, f. 416; Fallmerayer, Vëll. VIII, f. 367-8.

26) Theiner, «Monumenta Slavorum», Vëll. I, fq. 367-8, ndjesë e plotë.

i Shenjtë Romak Sigismundi e muarën nën mbrojtjen e tyre. Edhe bizantini Halkondilla, zemra e të cilit ishte zbutur prej një Komneneje të largët, stërgjyshe e Arianitit, ishte i shtrënguar ta pranonte se «në atë ekspeditë, Araniti, i biri i Komnenit, fitoi një lavdi të madhe, duke bërë vepra të përkujtueshme; dhe që atëhere u bë njeri i dëgjuar»<sup>(27)</sup>.

Shumica e popullatës së Shqipërisë së Skënderbeut ishte katolike - romane. Si pasojë, tërë bota katolike - romane, e cila në atë kohë përfshinte krejt Evropën me përjashtim të Rusisë e të Gadishullit Ballkanik, ishte thellësisht e interesuar në luftën e Skënderbeut kundër turqvet. Kuptohet vetiu se vendet fqinjë mbi detin Adriatik, si Shteti i Papës, Mbretëria e Napolit, Republika e Venedikut, Qyteti i Raguzës dhe Mbretëria Hungareze, të kërcënuara nga rreziku i invadimit turk, ishin të interesuara në mënyrë jetike dhe bënин çmos për t'u ndihmuar shqiptarëvet që t'i ndalonin turqit, kur këta gjendeshin përparrë portave të tyre. Përkrahja e tyre dolli e pamjaftueshme. Megjithatë, ajo qe aq e madhe sa ta ngrinte rezistençën shqiptare në lartësi epike.

Foigti (Voigt) dhe Falmerajeri na thonë se papët i ndihmuan Skënderbeut vetëm me bekime apostolike dhe me ligjërata panegjirike<sup>(28)</sup>. Por kjo është aq e padrejtë sa edhe e gabuar. Ka dokumenta që provoj-

27) Laonikos, Libri V, f. 251. Araniti korri edhe dy fitore të tjera kundër turqvet. Krh. «Diplomatarium Ragusanum», 1434, gusht 16, f. 386-7: «...Shqiptarët bënë një luftë shumë të rreptë dhe puna arriti që, nga ana e turqve, të vriteshin shumë e shumë veta; njëkohësisht edhe shqiptarët patën humbje nga ana e tyre, por, megjithatë, mbeten me fitore në fushën e betejës...» Po ashtu, po aty, 16 shkurt, 1435, f. 389: «Në festën e shën Stefanit, pas kremtimit të lindjes së Zotit tonë, Jezu Krishtit, vojvodë Isaku i turqve, i cili kishte ardhur në Shqipëri me një ushtri të madhe e të fuqishme, e përballë të cilët qëndronte Arnit Spata, zot i parë dhe udhëheqës në Shqipëri, si u përllesh në betejë me një ushtri të fortë shqiptarësh, duke luftuar të dy palët me rreptësinë më të madhe, Isaku vetë u thye dhe u vu në ikje nga po ai Arnit». Kjo fitore vërtetohet edhe nga Leunclavius, gjermanisht, fq. 21, viti 1432: Leunclavius latinisht, fq. 36, viti 1432.

28) Fallmerayer, Vell. IX, f. 88; Voigt, Vell. III, f. 54.

në se papët Nikolla V (1447-1453), Kaliksti III (1453-58), Piu II (1458-1473) i ndihmuani Skënderbeut me të Holla tingëlluese që arrinin në mijëra dukatë ari të thesarit papal<sup>(29)</sup>. Veç kësaj, është e drejtë të merret me mend se shumat e parave që ata i dhanë ishin në çdo rast më të mëdha se ato të çdo shteti tjetër të veçantë<sup>(30)</sup>. Dhuratave të tyre duhet t'u shtohen edhe fondet e mbledhura nga legatët e papëve si brenda në Shqipëri, ashtu edhe përjashta, posaçërisht në Dalmaci<sup>(31)</sup>, për kryqëzatën e Skënderbeut. Arësyet e kësaj përkrahjeje të vazhdueshme janë të qarta: Shqipëria ishte kryeura e fundit katolike-romane në Ballkan dhe papët bënин çmos për ta ruajtur dhe për ta zgjeruar. Duke filluar që nga shekulli i njëmbëdhjetë, papëvet u që dashur të merreshin me udhëheqjen e një kryqëzate të pandërprerë kundër arabëvet dhe turqvet. Skënderbeu ishte aleati i tyre më i sigurt, sepse pothuaj për njëzet e pesë vjet luftoi vazhdimisht kundër armikut të përbashkët, vetëm me dy ndërprerje të shkurtër prej afër gjashtë muajsh secila<sup>(32)</sup>. Kaliksti III e ka pranuar në një letër se Skënderbeu ka bërë për fenë më tepër se gjithë princërit e tjerë katolikë<sup>(33)</sup>. Në një letër tjetër, Kaliksti e këshillonte legatin e tij t'i dorëzonte Mbretit të Bosnjës një pjesë të fondeve të mbledhura në Dalmaci për kryqëzatën, që ky, i nxi-

29) Cugnoni, Nr. XXXIX, f. 100; Sht. Nr. 8; Farlati, Vëll. VII, f. 421; Sht. Nr. 19; Marinesco, f. 132; Canensius, f. 148; notë 3, Sht. nr. 50; Pastor, Vëll. IV, f. 86, 89-90; Gegaj, f. 144, notë 5; f. 145, notat 1, 2; Bertoloti, Petrovitch, f. 117.

30) Më 1467 Skënderbeu mori si ndihmë 1500 dukatë nga Ferdinandi i Napolit, 3400 nga Venediku dhe 9250 nga Papë Pali II. Krh. Trinchera, «Codice Aragonese», f. 90, Sht. Nr. 40; Ljubic, Vëll. X, Nr. CCCCII, f. 387, po aty, Nr. CCCCCXVI, f. 399; Pastor, Vëll. IV f. 86, 89-90; Gegaj, f. 144-45.

31) Theiner, «Monumenta Slavorum», Vëll. I, Nr. DCII, f. 427-8; Sht. Nr. 15; po aty, Nr. DCXIII, f. 432; Sht. Nr. 17; Makushev, «Razyskaniya», f. 93.

32) Pothuajse gjashtë muaj më 1461-62 dhe pothuajse shtatë muaj më 1463.

33) «Sepse, me trimërinë e shkëlqyer dhe me veprat e tua të paharrueshme, ne shohim që ke fituar merita shumë të mëdha ndaj besimit dhe fesë së krishterë, përmbi të gjithë princërit katolikë... Theiner «Monumenta Sacra», Vëll. II, f. 303; Sht. 14.

tur nga ndihma financiare, të bëhej «një Skënderbe tjetër»<sup>(34)</sup>. Papa i mirë plak spanjoll e dinte fare bukur se, për financimin e një kryqëzate, duhesin para në dorë, dhe jo retorikë boshe. Përpara këtyre fakteve, është mjaft e vështirë të kuptohet përsë në «Historinë Butërore» të Langerit papët as përmenden fare, me gjithqë ata meritojnë sigurisht vendin e parë midis përkrahësve finanziarë të Skënderbeut<sup>(35)</sup>.

Napoli, i dyti po menjëherë pas Romës, ka dhënë një ndihmë që kuptohet fare mirë, po të marrim parasysh faktin se bregu lindor i mbretërisë së Napolit gjëndej vetëm pesëdhjetë milje larg, në disa pika midis Brindisit dhe Vlorës. Kështu, me qëllim vetëmbrojtjeje, mbretërit e Napolit i ndihmuani Skënderbeut për ta zgjatur qëndresën e tij dhe për ta mbrojtur Shqipërinë, e cila ishte, në një farë kuptimi, një kryeurë napolitane. Veç kësaj, ashtu siç e tregon Marineskoja, nuk ishte vetëm ndjenja e vetëmbrojtjes që e nxiti qëndrimin e mbretërvet napolitanë, po edhe ëndra e tyre për të krijuar një Perandori Mesdhetare Katalane që do të shtrihej prej Barcelonës gjer në Konstantinopol<sup>(36)</sup>. Bashkë me Napolin dhe Sigelinë, Alfonsi V, Mbret i Aragonës, trashëgoi edhe ambicjet e paraardhësve të tij, Frederikut II, Robert Guiskardit dhe Karlit të Anzhuve. Dokumenta të botuara ose të përdorura prej dijetarëvet si Makushevi<sup>(37)</sup>, Cerone<sup>(38)</sup>, Trinkera<sup>(39)</sup> dhe Marineskoja<sup>(40)</sup> provojnë në mënyrë përfundimtare se Skënderbeu ka marrë prej Na-

34) «...me qëllim që, me ndihmën e tyre, një tjetër të nxitet për të luftuar me burrëri më të madhe kundër turqvet, d.m.th. të bëhet një Skënderbe i dytë....» Rinaldi, Vell. X, v. 1457, Nr. 70, f. 107; Sht. 18.

35) Langer, William Leonard, «Një Enciklopedi e Historisë Botërore», Houghton Mifflin, Boston 1940, f. 332.

36) «Kryqëzatë që kishte për ta bërë mbretin Alfons V zot të pellgut lindor të Mesdheut, ashtu siç ishte tashmë i atij të perëndimit». Marinesco, f. 45; Jorga, «Brève Histoire» («Histori e shkurtër»), f. 47.

37) Makushev, «Monumenta Slavorum», Vell. II, f. 148-9.

38) Cerone, Vol. XXVII, f. 210.

39) Trinchera, «Codice Aragonese», f. 90; Sht. Nr. 40.

40) Marinesco, f. 97; nota 2; faqet 130-131.

polit ndihma shumë të rëndësishme në të holla, armë, ushqime dhe ushtarë. Po, nga ana tjetër, është një egzagjerim i madh t'i vesh mbretërit e Napolit përparrë Papëve si përkrahës të Skënderbeut, dhe një absurditet ta konsiderosh Skënderbenë si një «condottiere» (kapedan trupash mercenare) të thjeshtë në shërbim të Napolit ose të Venedikut, ashtu si bëjnë Jorga (41) dhe Langeri (42).

Makushevi e përshkruan politikën e Venedikut, në tokat shqiptare të sunduara prej tij, si një luftë çfarosjeje kundër gjithë klasave shoqërore shqiptare (43). Në qytetet shqiptare të Durrësit, Leshit, Shkodrës, Drishtit, Ulqinit dhe Tivarit, që kishte aneksuar Venediku, aristokracia po poshtërohej, borgjezia po rrënohej dhe fshatarët e lirë po bëheshin bujqrobër. Në përgjithësi, aneksimi i tokës shqiptare vinte pastaj si fazë e fundit e këtij procesi. Krerët e fiseve shqiptare ishin të subvencionuar dhe të nxitur ta luftonin Turqinë deri sa të mbyteshin në gjak dhe të shtrëngohen pastaj t'i jepeshin pa kushte Venedikut, si një e keqe më e vogël se sa Turqia. Mbas nënshtimit të tyre, ata trajtoheshin si skllevër të një vendi kolonial. Kur krerët e fiseve ishin tepër të fortë për t'u shtypur prej turqve, Venediku nuk ngurronë t'u binte me thikë në shpinë, duke nxitur luftën vëllavrasëse midis tyre ose, bile, duke shpallur dhe luftë kundër tyre. Ai kishte shkatërruar Balshajt, dhe shpresonte ta përsërishte të njëjtën metodë edhe kundër Skënderbeut. Tri herë të paktën Skënderbeu u propozoi venedikasvet t'u dorëzonte Krujën, me qëllim që ta shpëtonte atë nga turqit (44), por venedikasit nuk pranuan, sepse besonin që Skënderbeu, me malësorët e tij, ishte tepër i fortë

41) «...Kur, një kohë, trupat e Sulltanit ja arritën qëllimit që ta dëbonin, ai nuk ndjeu asnjë turp të shkonte në Itali, si një kryetar i thjeshtë mercenarësh dhe të ndiqte çështjen e këtij mbreti të Napolit, që kishte qenë edhe një nga mbrojtësit e tij të vazhdueshëm». Jorga, «Histori e shkurtër», f. 45.

42) «Condottiere, i edukuar në oborrin turk...» Langer, «Histori e Përbotëshme», faqe 332.

43) Makushev, «Razyskania», f. 133 dhe faqet 146-47

44) Më 1449, më 1450 dhe më 1466.

për t'u bërë shërbëtori i tyre i bindur. Ata donin më mirë ta shihnin Krujën të sunduar prej turqvet se sa ta zotëronin vetë, para se banorët e saj të ishin shkatteruar dhe mundur. Fakti është se ata e morën përsipër mbrojtjen e qytetit vetëm mbasi vdiq Skënderbeu më 1468, dhe e aneksuan qytetin vetëm më 1474, kur populli ishte i ronitur dhe mund të skillavërohej me siguri. Në këtë mënyrë venedikasit lejuan që gjithë qytetet e Shqipërisë së jugut të binin në duart e turqvet, ndonëse herë pas here u qe dhënë rast që t'i merrnin nën mbrojtjen e tyre, po të kishin dashur t'i pranonin. Është e qartë se venedikasit mendonin që Shqipëria mund t'u rrëmbehej turqve shumë më lehtë se sa shqiptarëvet vetë. Mjaft e çuditëshme është që, me përjashtimin e disa ndërprerjeve të shkurtra, ata vazhduan ta subvencjononin Skënderbenë, ndonëse e urrenin me gjithë shpirt! Ata ndoqën një politikë të tillë, ngandonjëherë, sepse donin t'u bënin luftë turqvet, po pa u dukur, që të mbronin kolonitë e tyre shqiptare<sup>(45)</sup>; herë të tjera, sepse ishin të detyruar ta blinin paqën nga «i tmershmi» Skënderbe (46), si përshembull më 1448 dhe 1457; herë të tjera, sepse ishin trembur për vdekje nga Mehmeti II, si në vitin 1453, pas rënies së Konstantinopolit; dhe hierë të tjera prapë, sepse ata ja kishin nevojën së tepërmë Skënderbeut si një aleat kundër turqvet, ashtu si ngjau më 1463-68. Por, edhe gjatë kësaj periudhe të fundit, ata u lejuan «proveditorëve» (guvernatorëve) të tyre në Shqipëri që ta pengonin Skënderbenë në çdo hap të tij dhe t'i binin me thikë në shpinë. Më në fund, Skënderbeu nuk deshi të pranonte trupa ndihmëse venedikase, përveç se po të viheshin nën komandën e tij të drejtëpërdrejtë<sup>(47)</sup>. Pak ditë para vdekjes së Skënderbeut, senati venedikas nisi në Shqipëri të dërguar të posaçëm për të hetuar dhe për të raportuar mbi ankimet e Skënderbeut kundër proveditorëve tradhëtarë që

45) «...Kjo ish t'u bëje turqvet një luftë defensive pa u dukur». Jorga: «Brève Histoire» (Histori e Shkurtër), f. 46.

46) Romanin, Vëll. IV, faqet 243-44.

47) Ljubiç, Vëll. X, f. 334, Sht. Nr. 37.

vepronin sigurisht në bazë të urdhrale të marra dhe që duhej të ishin fajtorë vetëm se nuk i kishin bërë mirë llogaritë me veten e tyre<sup>(48)</sup>.

Qyteti i pasur i Raguzës nuk e harroi kurrë origjinën e tij romake dhe vazhdoi ta përdorte latinish-tët dhe italishten si gjuhë të tij zyrtare, edhe pasi u sllavizua krejtësisht<sup>(49)</sup>. Raguza ishte, sa për emër, nën vartësinë hungareze, por, për të tjerat, gjëzonte një vetqeverim të pakufizuar. Ushtria e flota e saj ishin tepër të dobëta për mbrojtje, dhe nuk i bënин dot ballë një agresioni. Paraja dhe tregëtia ishin të vetmet armë që patricët raguzanë i përdornin për të subvencionuar gjithë ata që e luftonin Turqinë, agresorin më të rrezikshëm të asaj kohe. Skënderbeu ishte aleati i tyre natyral, si dhe një klient që blente mallrat e tyre. Ata vepronin edhe si bankierët e tij<sup>(50)</sup>. Qyteti kishte edhe një popullatë të madhe shqiptarësh, dhe disa prej qytetarëve shqiptarë kishin arri-tur të ngriheshin në radhët e klasave të larta<sup>(51)</sup>. Ashtu si gjithë qytetet e Dalmacisë së jugut, Raguza kish shumë klerikë dhe murgj shqiptarë që kishin monopolizuar pothuajse gjithë shërbimet kishtare<sup>(52)</sup>. Kjo i spjegon marrëdhëniet e përzemërtë që egzistonë midis Raguzës dhe Skënderbeut, si dhe pritet e shkëlqyera që iu bënë këtij çdo herë që vizitoi qytetin. Është pothuajse e sigurtë që trupat e tij u mbartën për në Itali dhe u kthyen prapë në Shqipëri, më 1461-62, me anën e anijeve të Raguzës<sup>(53)</sup>.

---

48) Makushev, «Razyskania», f. 111.

49) Në Raguzë, protokollet e Këshillit mbaheshin gjithmonë latinisht gjer në rënien e Republikës (1808). Edhe në Mesjetën e vonët, raguzanët quheshin prej sllavëve, «Latini», sikundër quhej Italia prej tyre «Latinska Zemla» dhe gjuha italishtë «Latinski Jezik». Jirecek, «Handelsstrassen», faqe 4.

50) Miklosich, Nr. CCCLVI, f. 442, si dhe Nr. CCCLXXXV, f. 481.

51) «Këtu (në Raguzë) gjënden edhe pjesëtarë të familjeve patrice nga Drishti: Suma, Palombo, Lapore dhe Span». Sufflay, «Kirchenzustände» (Gjëndja e kishave), «Forschungen», Vëll. I, faqet 265-267.

52) Këtu autori ka harruar një shënim (sh. i red.).

53) Villari, f. 247.

Si çdo komb tjetër europjan, edhe hungarezët ëndëruan të merrnin Stambollin. Ata e rrethuan këtë qytet apo u dukën për herën e parë në Europë. Dështuan në atë kohë, por, në shekullin e pesëmbëdhjetë, menduan se kishin gjetur një rast të vërtetë për t'ja dalë në krye këtij qëllimi. I vetmi konkurent i tyre ishte Turku. Kishin një gjeneral të madh për t'i udhëhequr, Janko Huniadin dhe mbreti i tyre, Vladislavi IV, kishte marrë kurorat e Hungarisë dhe të Polonisë bashkë. Por ata e muarën vesh shpejt se nuk mund të mateshin me Turkun dhe kaluan nga ofensiva në defensivë. Përsëri Skënderbeu u bë aleati i tyre natyral. Në vitin 1457, Papa Kaliksti III i këshilloi legatët e tij në Raguzë që t'ua jepnin fondet e kryqëzatës, të mbledhura në Dalmaci, si t'i ndanin në tri pjesë të njëjta, mbretit të Hungarisë, mbretit të Bosnjës dhe Skënderbeut<sup>(54)</sup>. Barleti, Biemi, Laoniku, Kritobuli, Bonfini dhe burimet raguzane flasin herë pas here për një aleancë që egzistonte midis Skënderbeut dhe hungarezëve<sup>(55)</sup>.

Perandoritë e vjetra të Lindjes po shembeshin njëra pas tjetrës dhe një perandori e re po ngrihej mbi gërmadhat e tyre. Perandoritë që po binin ishin ato të bizantinëve, të bullgarëve dhe të serbëve. Ajo që po ngrihej ishte e osmanllivet turq. Para vitit 1082, Perandoria Bizantine ishte një perandori e Njëmijë e Një Qyteteve. Pas vitit 1082 ajo u bë një perandori e njëmijë e një feudeve. Pra, atëhere ra Konstantinopoli, dhe jo më 1204 ose më 1453. Privilegjet tregëtare që iu dhanë venedikasvet më 1082 i rrënuan qytetet dhe e ktheyen borgjezinë e pasur në një *Lumpenproletariat* të uritur dhe turbullues<sup>(56)</sup>. Në anë tjetër,

54) Theiner, «Monumenta Slavorum», Vëll. I, Nr. DCXIII faqe 432, ap. Nr. 17.

55) Barleti, Libri II, faqet 51-57; Biemmi, Libri I, faqet 59-65; Laoniku, Libri VII, faqe 357; Kritobulis frengjisht, Libri V, par. 91; Sht. Nr. 54; Bonfinius, Antonius, «Rerum Hungaricarum Decades», Frankfurt, Andrea Wechel, faqet 300-307; Villari, faqet 229-230; Munaxhim Bashi te Jastrebovi, f. 383.

56) Vasiliev, Vëll. II, faqet 396-97, mbi Komunën e Thesalonikës.

pronat e mëdha i bënë fshatarët e lirë të katandise-shin në bujqrobër. Atëhere Perandoria Bizantine u kthye në njëmijë e një copë. Dili (Diehl) në librin e tij «Bizance, Grandeur et Décadence»<sup>(57)</sup> (Bizanti, madhështi e rënie), na e përshkruan mirë këtë ngritje vdekjeprurëse të feudalizmit që e bëri hi Perandorinë Bizantine dhe ja pregeti rrugën rënies së Konstantinopolit në duart e venedikasvet më 1204 dhe të turq-vet më 1453. Gjendja e dëshpëruar u shpreh qartë me parullën e disfatistëve bizantinë: «*Më mirë Turku se Frengu!*» E vetmja gjë që u mbetej për të bë-rë ishte të zgjidhnin një zot. Ata preferuan Turkun dhe e gjetën.

Bullgaria dhe Serbia në shekullin e pesëmbëdhjetë s'ishin gjë tjetër veçse karikatura të Perandorisë Bizantine që po hiqte shpirt. Popullata e tyre përbëhej vetëm nga dy klasa: pronarët e tokës dhe bujqrobërit<sup>(58)</sup>. Borgjezia e tyre nuk ishte mjaft e fortë për të lojtur një rol të rëndësishëm. Ato ranë në prehërin e Turkut posi kumbulla të arrira.

Turqit erdhën në Europë si çlirimtarët e bujqrobërvë dhe të klasave të shtypura. Ata u premtonin lirinë<sup>(59)</sup>. Kjo na spjegon deri në një farë pike se si ata arritën të krijonin një perandori aq të madhe mbrenda një kohe aq të shkurtër. Kishte dhe arësyte të tjera. Në një botë ushtarësh mercenarë, ata ishin të parët që krijuan një ushtri kombëtare të përherëshme, jeniçerët, që luftonin për Turqinë dhe jo për një

57) Diehl, kap. III, «Le Péril Féodal et la lutte des classes» (Rre-ziku feudal dhe lufta e klasave), faqet 165-179.

58) «Populli, në shumicën e tij të madhe, qe bujkrob». Jirecek, «Bulgaren» f. 374. «Bujqët ishin shumë të shtypur në gjithë vendet e krishtera të Ballkanit...» Jirecek, «Serben», II, faqe 100. «Pas vitit 1371, Serbia nuk qe më një mbretëri e bashkuar, por vetëm një konglomerat krahinash të fisnikëvet», po aty, f. 104.

59) «Turqit erdhën si çlirimtarë të bujqve dhe të bogomilëve», Jirecek, «Bulgaren», f. 374. «Kundër atyre të krishterëve që nuk bënë rezistencë turqit u suallën butë, porse u përpinqën kudo t'i ngrinin fshatarët kundër zotërve të tyre, dhe u premtuan liri të plotë». Jirecek, «Serben», Vëll, II, faqe 102.

pagë<sup>(60)</sup>. Historianët nuk janë të gjithë të një mendimi mbi metodat, me anën e të cilave rekrutoheshin jenicerët. Langeri është i mendimit se «devshirmeja» e famëshme ose «tributi në fëmijë» përdorej vetëm rastësisht dhe se metoda e zakonshme ishte ajo e zgjedhjes së rekrutëve midis robërve të rinj të luftës<sup>(61)</sup>. Por metoda nuk ka rëndësi. Rezultati mbetej po ay. Turqit kanë qenë po ashtu të parët që mobilizuan ushtri të mëdha dhe që përdorën artileri të rëndë rrëthimi në mënyrë të gjërë për të rrënuar muret e kështjellave<sup>(62)</sup>. Veç kësaj ata arritën, të paktën gjatë tre shekujve të parë të historisë së tyre, të kenë një qeveri të qëndrueshme dhe një grup oficerësh ushtarake dhe administratorësh civilë të stërvitur mirë. Çdo zyrë, nga më e ulta deri te më e larta, mbetej e hapur për çdo të krishter të përgatitur si duhej, po të përqafonte ky islamizmin.

Një barazi e tillë ka të ngjarë të këtë tërhequr mijëra njerëz që të ndërronin fenë në botën feudale, në të cilën gjithë funksionet e larta i kishin monopolizuar klasat e larta<sup>(63)</sup>. Bujqrobërit e kësaj bote feudale s'kishin asnjë interes të mbronin zotërit e tyre - dhe asnjë vështirësi të ndërronin zot. Por fshatarët e lirë, shqiptarë i mbrojtën liritë e tyre dhe, ndryshe nga fqinjët e tyre, bënë qendresën më të gjatë dhe më të ashpër që mund të ketë shënuar ndonjë herë historia. Sipas Falmerajerit, i vetmi krahasim që vlen të përmendet është ai që gjejmë në mbrojtjen heroike të Jeruzalemit dhe të Numancies kundër romakë-

60) Mitchell, William A., «Outlines of the World's Military History (Skicë e Historisë Ushtarake të Përbotëshme), Harrisburg, Pa., Military Service Publishing Company, 1940, par. 1006, faqe 246.

61) «Grabitja dhe rekrutimi i fëmijëvet të krishterë u përdoren vetëm gradualisht dhe çregullisht në Turqi, me qëllim që të plotësoheshin radhët e regjimenteve», Langer — Blake, «Osmanen», f. 503.

62) Mitchell, «Military History» (Histori Ushtarake) par 1027, f. 259.

63) «Zyrat e perandorisë dhe të pallatit qenë pa përjashtim pronë e bojarëvet, si në Serbi, sipas shembullit bizantin», Jireček, «Bulgaren», f. 385.

vet<sup>(64)</sup>. Humanisti Filelfo e thotë shprehimisht se shqiptarët qenë i vetmi komb në Ballkan, që i ndaluan turqit<sup>(65)</sup>. Bile dhe historianët bizantinë, anti-shqiptarë dhe turkofilë, Laoniku dhe Kritobuli, shprehin ndonëse kundër dëshirës së tyre, admirim për heroizmin e malsorëvet shqiptarë<sup>(66)</sup>. Analistët turq s'bëjnë asnje përpjekje për të pakësuar rëndësinë e fushatave të Shqipërisë. Autori anonim i «Kronikëve të vjetra osmane» (*Altosmanische Chroniken*), i quan ato «kryqëzata të mëdha»<sup>(67)</sup>. Ashik Pasha Zade flet për mijëra muslimanë besnikë që dhanë jetën në këto fushata dhe që, në këtë mënyrë, fituan lumtérinë e përjetëshme si një shpërblim për sakrificën e tyre të lartë në këtë luftë të shenjtë<sup>(68)</sup>. Volteri, në përshkrimin e tij të shkurtër të njeriut që organizoi këtë rezistencë epike, vëren: «Po të kishin qenë perandorët grekë burra si Skënderbeu, Perandoria e Lindjes do të kishte shpëtuar»<sup>(69)</sup>.

64) «Në këtë mënyrë, për turp jo të vogël të fqinjëve më të fuqishëm, por më pak të vendosur, shqiptarët e mbrojtën pavarësinë dhe nderin e arrnëve të atdheut përmbi një gjysmë shekulli, me një trimëri dhe këmbëngulje, të cilave mund t'u gjejmë një shembull vetëm në qëndresën e Numancies dhe të Jeruzalemit kundër Romës, që synonte të sundonte botën». Fallmerayer, VIII, f. 710.

65) «Të vetmit nga të gjitha fiset midis Danubit, Adriatikut dhe kufive të Italisë që u kanë bërë ballë përherë turqve me burrërinë më të madhe». Rinaldi, X, viti 1463, Nr. 52 f. 353; Sht. Nr. 47.

66) «Luftonin me dëshpërim, me forcën më të madhe». Laoniku VII, f. 335. Krh. Kritobulin, par. 71; Sht. 54.

67) «Një luftë e madhe fetare». Turqisht «Gazai ekber». «Altosmanische», faqe 150, Sht. Nr. 53.

68) Kapitulli III, faqe 112.

69) «Si les empereurs grecs avaient été des Scanderbegs, l'Empire d'Orient se serait conservé». Voltaire, IV, kap. XC, faqe 247.

## KAPITULLI II

### FILLIME LEGJENDARE

(1405-1443)

Falmerajeri e ka thënë fare bukur se ai që kërkon rrënjet e krerëve të malësive të Shqipërisë, humbet kohën dhe mundohet kot.<sup>(1)</sup> Me pak përjashtime, origjina e tyre është modeste si ajo e Balshajve<sup>(2)</sup> dhe e Kastriotëve<sup>(3)</sup>. Ashtu si na e thotë Jireçeku, çdo shqiptar kishte dy emra, një emër të parë që rrallë ishte emër kombëtar, dhe një mbiemër që ishte ai i fisit ose i katundit të vet<sup>(4)</sup>. Për shembull, mbiemrat Kastrioti, Balsha<sup>(5)</sup>, Muzaka, Araniti dhe Shpata<sup>(6)</sup>, janë emëra katundesh që ekzistojnë ende në Shqipëri. Dokumenti i Fermenxhinit e tregon në

1) «Të gjesh origjinën e një kreu fisi shqiptar është një mundim sa i kotë aq dhe i padobishëm». Fallmerayer, Vëll. VIII, faqe 712.

2) «Orbini... shkruan... se, në ditët e Dushanit, Balsha nuk ka pasur në zotërim asgjë tjetër veçse një fshat, Zeddën». Gelcich; Zedda, faqe 30, Krh. Jireçekun, «Serben», Vëll. I, faqe 425.

3) «Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe... nuk kishte më tepër se dy fshatra...» Hopf, «Chroniques», faqe 301.

4) Jireçek, «Forschungen», Vëll. I, faqe 70.

5) «Ka dy katunde që quhen Balshi: njeri në Shqipërinë e veriut dhe tjetri në Shqipërinë e jugut. Që të dy format, Balshi dhe Balsha janë të mundëshme në gjuhën shqipe. Jireçeku është i mendimit se rrënja është iliriane dhe prapashtesa - serbe ose rumune, Krh. «Serben», Vëll. I, f. 425. Prapashtesa «-sha» nuk është panjohur në shqipen, ashtu si provohet, për shembull, me mbiemrat «Ljosha» dhe «Zanebisha», të të njëjtës periudhë.

6) Balshi, Muzaka, Araniti dhe Shpata përdoren deri më sot në Shqipëri si mbiemra.

mënyrë të çkoqur që Kastriotët quheshin kështu, sepse ishin nga një katund i quajtur Kastriot, në malësinë e Hasit<sup>(7)</sup>. Lukari i përmendur prej Falmerajerit, na e vërteton këtë, ndonëse e shkruan keq si emrin e katundit ashtu edhe atë të malësisë<sup>(8)</sup>. Emëri i kësaj të fundit, ndonëse i shkrojtur keq, njihet shpejt, por «*Villa Castrati*» në vend që të shkruhej «*Castrioti*» ishte burim konfuzioni, sepse egziston një fis «*Kastrati*» në Shqipërinë e Veriut<sup>(9)</sup> dhe po ashtu ka një katund «*Kastrioti*», në Shqipërinë veriperëndimore<sup>(10)</sup>. Dokumenti i Fermentxinit i panjohur gjer tani, e çkoqit se atje ish fjala për katundin Kastrioti dhe jo për fisin Kastrati.

«Branilo Kastrioti prej origjine serbe» është përmendur si stërgjyshi i Skënderbeut në pasqyrën gjenalogjike të familjes Kastrioti, që jep Hopfi<sup>(11)</sup>. Historia e këtij paraardhësi bazohet në një dokument të Vlorës të vitit 1368<sup>(12)</sup>, dhe në një frazë të Spanduginos, autorit të librit «Traktat mbi derën e Osmanit»<sup>(13)</sup>. Dokumenti, që përmban betimin e dhënë prej Aleksandër Komnen Asenit, princit bullgar të Vlorës dhe Kaninës, si qytetar nderi i Raguzës, përmban edhe nënshkrimin e një *Kastrioti* kështjellar i Kaninës, bashkë me ato të disa dëshmonjësve vërtetonijs të

7) «Castrioich (sic) nga Kastrioti në krahinën Az të Epirit» Fermentxin, faqe 560; Sht. Nr. 52.

8) «Gjon Kastrioti, Zot i Krushës, familja e të cilit dolli nga fishati i Kastratit në krahinën e Asit të Shqipërisë, jo shumë larg lumen Drin». Luccari, faqe 86. Në këtë pjesë të librit, në vend të «Asit», që është forma italiane, se italianët fjalët e huaja me Hnuk i shprehin dot, duhet lexuar «Has». Fallmerayer, Vëll.. VIII, faqe 713, nota 1.

9) Barbarich, faqé 177.

10) Jastrebov, faqet 123, 226-227.

11) Hopf, «Chroniques», f. 533; krh. Hahn, «Reise», Vëll. XVI f. 115.

12) Dokumenti është botuar në gjuhën origjinale sllavishte prej Miklosichit, Nr. CLIII, 2 shtator 1368, faqe 178-79, dhe prej Novakovichit, Nr. LIII, faqe 190-91; në një përkthim latinisht prej Sufflayit, në «Acta», Nr. 259, f. 57, me shënimë sqaruese. Ai është komentuar prej Thalloczyit dhe Jirečekut në «Zwei Urkunden», f. 88, dhe në «Forchungen», faqe 137; Sht. Nr. 1.

13) Hopf, «Chroniques», faqet 315-335; Sansovino, f. 189-215; cfr. Lybyer, f. 310.

tjerë nga parësia e vendit. Emri i këtij *Kastrioti* vjen pas atij të një farë Braniloje, një emër sllav, të cilin Hopfi e lexon si emrin e parë të këtij Kastrioti. Por, midis tyre, ka një lidhëse sllave «i»<sup>(14)</sup>, e cila duket se i dallon ata si të dy personave të ndryshëm, ashtu si pretendon Sufflay<sup>(15)</sup>. Por edhe sikur ta pranojmë që Branilua të ketë qenë emri i parë i këtij Kastrioti, kjo nuk do të thotë se ai ishte serb; ashtu si na e thotë Jireçeku<sup>(16)</sup>, emri i parë i një shqiptari ishte rrallë shqiptar, por zakonisht grek, sllav ose latin. Më në fund, nuk ka asgjë në këtë dokument që të tregojë se ky «Branilo Kastrioti» ishte stërgjyshi i Skënderbeut. Si rrjedhim, e vetmja gjë që mund t'i themi Hopfit është kjo: «*Ka q shumë gjëra me dy fjalë!*»<sup>(17)</sup>. Tregimi i Spanduginos mund të shkaktojë polemikë edhe më të madhe. Ai e karakterizon Skënderbeun si «*per natura serviano*», sipas variantit të Sansovinos<sup>(18)</sup>. Dorëshkrimi i Spanduginos, i botuar prej Hopfit, u shkrojt më 1535<sup>(19)</sup>, domethënë gjashtëdhjetë e shtatë vjet pas vdekjes së Skënderbeut, që do të thotë se ai është shumë larg nga dëshmia e një ba-

14) Nënëshkrimet në sllavishten janë si vijon: «*Prodan vojvoda i Mikleus, kefalia vavlonski Branilo i kefalia kaninski Kastriot...*».

Në latinishten: «*Prodan vojvoda et Micleus, castellanus Aulonae Branilo et castellanus Caninae Castriot...*» «Acta», Nr. 249, faqe 57; Sht. Nr. 1.

15) «Me qënë se ky mbiemër (Kastriot)... figuron pa emër të përveçëm, Hopfi 2, 122, dhe Makushevi, Ist. Raz. 61, kujtonin se emri «Branilo» i përkiste atij, gjë që e hedhin poshtë plotësisht vetë radhitja e fjalëve, ajo që thamë në shënimin e mëparëshëm dhe Muzaka në historinë e vet....

Sufflay, «Acta», Nr. 249, faqe 57, kol. 2, nota 1. Thalloczy dhe Jireçek, «*Zwei Urkunden*», në Arkivën e Letërsisë Sllave, Vëll. XXI, faqe 88, shprehen kështu: «Sipas tekstit, Branilo sikur s'i përket emrit Kastrioti, ashtu siç e ka kuptuar Hopfi», por në «Forschungen», f. 137, ata kanë ndruar mendjen: «Sipas tekstit, Branilo **ndoshta** i përket emrit Kastrioti, sikundër e kuption Hopfi». Nënvizimet janë tonat.

16) Jireçek, «*Forschungen*», Vëll. I, faqe 70.

17) Hopf, «*Chroniques*», f. 334.

18) Sansovino, «*Spandugino*», faqe 201.

19) Hopf, «*Chroniques*», Hyrja, f. XXXV.